

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7687 E martë 23 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion *i* Ditës

**Shoqëria shqiptare, kudo ku jeton, spor sidomos në Shqipëri, ka një problem të madh me bashkëjetesën dhe tolerimin e krimin. Shkaktarët e nivelit të lartë ...**  
Vijon në faqet 20-21

## Nga ADRI NURELLARI

**Lidhja e shqiptarëve me krimin dhe kostoja që shkaktohet në ekonomi**

## Dje në "The Guardian"

**Ka qenë javë e ngarkuar për atë që Këdikur e quanim "e vërteta". Qeveria saudite më në fund e ka pranuar që Xhemal Kashoggi është vrarë, edhe pse rrëfimi ...**  
Vijon në faqen 14

## Nga DAVID DWAN

**Fjala e lirë është e rëndësishme, por nuk mjafton**



Rezultatet për Patrullën e Përgjithshme  
**Patrulla e policisë, 2500 konkurrentët që kalojnë dhe ata që ngelin në fazën e parë**

Kush ka marrë mbi 50 pikë, do t'i nënshtrohet testit fizik. Si do bëhet njoftimi i kandidatëve  
Policia e Shtetit ka publikuar dje listën e kandidatëve fitues për Patrullën e Përgjithshme të policisë, pas testimit të zhvilluar më 15 dhe 16 tetor në Pallatin e Kongreseve. Sipas policisë, në fazën e parë të testimit me shkrim, ata që kanë marrë 50 pikë e sipër fitojnë të drejtën për të vijuar konkurrimin në fazën e dytë, në testimin fizik ...  
Në faqet 9-11

# EMRAT/ LABORATORI I DROGES NE HAS, POROSIA NGA "GRUPI I SHIJAKUT" HEROINA, 27 VETA NE PRANGA. ZBULOHET RRJETI I TRAFIKUT

Policia dhe prokuroria: Goditëm 4 grupe kriminale, 3 policë të arrestuar. Dyshimi për rolin e Lul Berishës. Hetimi çoi rastësisht në pranga 2 ish-deputetët



(Në foto) Operacioni policor i koduar "VOL-V0 4" Në faqet 2-3

**UDHEZIMI**  
**Lotaria Amerikane, ambasada: Kujdes kur jepni përgjigje të formulari**  
Në faqen 16

**GRUPI I DROGES**  
**Lulzim Basha kërkon arrestimin e Dakos. Rama: Të fortët do të vihen në rresht**  
Në faqen 4

**KRIMI TE BLOKU**  
**Gjykata e Apelit lë në burg Ervis Martinajn, avokati: Duhet të lirohet**  
Në faqen 8

**KONCESIONET**  
**Nisin hetimet për shërbimin spitalor, në fokus dializa**  
Në faqen 17

## EKSKLUZIVE/ Dyshimi për trafik droge, zbardhen bisedat e shijakasi të arrestuar

# Përgjimet: Hap një llogari, do vijë 500 mijë euro

Prokuroria: Hajri Seferi dhe grupi i tij, të ardhura të mëdha nga narkotikët

Në dosjen voluminoze të prokurorisë për grupin kriminal që trafikonte drogë, bien në sy shumica e mëdha të parave që ata lëviznin me njëri-tjetrin. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot një pjesë të përgjimit të njërit prej të arrestuarve, Hajri Seferi, i cili me sa kuptohet



Kështu me datë 03.04.2018, i dyshuari Hajri Seferi, përdorues i numrit 0699... komunikun me përdoruesin i numrit 68... dyshohet babai i tij pasi kjo rezultoi nga përmbajtja e përgjimit, sipas të cilit: "He babë.../Na foli i herë Kashoggi.../Po bre ma këto.../Ajo mirënjohëse Hajri.../Mirënjohëse.../Nga T.B, jam E., ka ardhë babi ktu dhe do të bëj ni veprim thotë do të hapj llogari të arkëtosh 500 mijë Euro sepse thotë do bëj pagesat e firmave, tani ma sqaro ni çfarë si domethënë për që do hapet llogaria.../Sepse do paguhet firma pra.../Do paguhet firma po me firmën ke lidh ndonjë kontratë paraparak.../Jo, jo, nuk kam asnjë lloj kontrate .../Po sa do jetë vlera e investimit sepse nuk lejohet që domethënë të bëhen pagesa nga një llogari individuale tek firma, nëse nuk ka një dokument përkatës...".  
Nga të dhënat e përtuara deri më tani nuk rezultoi që Hajri Seferi apo ndonjë i afër i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligshëm, dhe ka dyshime të arsyeshme të bazuara se këto transaksione të ardhura vijnë nga aktiviteti i...

kërkon të hapë një llogari bankare për të arkëtuar 500 mijë euro. Sipas prokurorisë: "Nuk rezultoi që Hajri Seferi apo ndonjë i afër i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligshëm dhe ka dyshime të arsyeshme, të bazuara se këto transaksione ..."  
Në faqen 2

# OPERACIONI ANTIDROGE ARRESTIMET

## Zbardhen bisedat e shijakasis të arrestuar, Hajri Seferi

### Përgjimet e trafikut të drogës: Hap një llogari, do vijnë 500 mijë euro

Në dosjen voluminoze të prokurorisë për grupin kriminal që trafikonte drogë, bien në sy shuma e mëdha të parave që ata lëviznin me njëri-tjetrin. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot një pjesë të përgjimit të njërit prej të arrestuarve, Hajri Seferi, i cili me sa kuptohet kërkoi të hapë një llogari bankare për të arkëtuar 500 mijë euro. Sipas prokurorisë: "Nuk rezultoi që Hajri Seferi apo ndonjë i afërt i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligjshëm dhe ka dyshime të arsyeshme, të bazuara se këto transaksione dhe të ardhura vijnë nga aktiviteti i tij kriminal dhe i grupit të tij kriminal", thuhet në dosjen e prokurorisë.

**DOSJA E PROKURORISË**  
"I dyshuari Hajri Seferi dhe bashkëpunëtorët e tij në veprimtarinë e tyre rezultojnë se përveç veprimeve të kundraligjshme në lidhje me narkotikët (si në trafikimin ashtu edhe në shitje, transportim, tregim, etj.), rezultojnë se kanë pasur përfitime të mëdha, të cilat i kanë investuar në pasuri të ndryshme. Kështu më datë 05.04.2018, i dyshuari Hajri Seferi, përdorues i numrit XXX komunikoi me përdoruesin e numrit XXX sipas të cilit: 'Na foli herë kështu.../Po bre ma kalo.../Alo mirëmengjesi.../Mirëmengjesi.../Nga T.B. jam E., ka ardhë këtu dhe do të bëj kontratë.../Po sa do jetë vlera e investimit sepse nuk lejohet që domethënë të bëhen pagesa nga një llogari individuale tek firma, nëse nuk ka një dokument përkatës...'.  
Nga të dhënat e përftuara deri më tani nuk rezultoi që Hajri Seferi apo ndonjë i afërt i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligjshëm, dhe ka dyshime të arsyeshme se këto transaksione dhe të ardhura vijnë nga aktiviteti i tij kriminal."

Faksimile e përgjimeve të komunikimit të tij kriminal.

**DOSJA E PROKURORISË**  
"I dyshuari Hajri Seferi dhe bashkëpunëtorët e tij në veprimtarinë e tyre rezultojnë se përveç veprimeve të kundraligjshme në lidhje me narkotikët (si në trafikimin ashtu edhe në shitje, transportim, tregim, etj.), rezultojnë se kanë pasur përfitime të mëdha, të cilat i kanë investuar në pasuri të ndryshme. Kështu më datë 05.04.2018, i dyshuari Hajri Seferi, përdorues i numrit XXX komunikoi me përdoruesin e numrit XXX sipas të cilit: 'Na foli herë kështu.../Po bre ma kalo.../Alo mirëmengjesi.../Mirëmengjesi.../Nga T.B. jam E., ka ardhë XXX dhe do të bëj kontratë.../Po sa do jetë vlera e investimit sepse nuk lejohet që domethënë të bëhen pagesa nga një llogari individuale tek firma, nëse nuk ka një dokument përkatës...'.  
Nga të dhënat e përftuara deri më tani nuk rezultoi që Hajri Seferi apo ndonjë i afërt i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligjshëm, dhe ka dyshime të arsyeshme se këto transaksione dhe të ardhura vijnë nga aktiviteti i tij kriminal."

ton se kanë pasur përfitime të mëdha, të cilat i kanë investuar në pasuri të ndryshme. Kështu më datë 05.04.2018, i dyshuari Hajri Seferi, përdorues i numrit XXX komunikoi me përdoruesin e numrit XXX sipas të cilit: 'Na foli herë kështu.../Po bre ma kalo.../Alo mirëmengjesi.../Mirëmengjesi.../Nga T.B. jam E., ka ardhë XXX dhe do të bëj kontratë.../Po sa do jetë vlera e investimit sepse nuk lejohet që domethënë të bëhen pagesa nga një llogari individuale tek firma, nëse nuk ka një dokument përkatës...'.  
Nga të dhënat e përftuara deri më tani nuk rezultoi që Hajri Seferi apo ndonjë i afërt i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligjshëm, dhe ka dyshime të arsyeshme se këto transaksione dhe të ardhura vijnë nga aktiviteti i tij kriminal."



"Koka" e biznesit të heroinës, biznesmeni Admir Hoxha. Hetimi për narkotikët zbuloi ish-deputetët Çuko e Ndoka

# Laboratori i drogës në Has, porosites grupi "Avdylaj"

## Do çohet në Gjermani, dyshimi: 'garantues' i transportit Lul Berisha

TIRANË

Grupi "Avdylaj" nga Shijaku, dyshohet se janë porositesit e sasisë së madhe të morfines që u bllokua në laboratorin e drogës që u zbulua pak ditë më parë në fshatin Brenog të Hasit. Lajmi konfirmohet nga Prokuroria për Krime të Rënda, e cila ka hetuar për afro 2 vite për veprimtarinë e grupit kriminal me bazë në Shijak. Referuar dosjes hetimore, rezultoi se grupi që drejtohet nga Jasin Avdyli (Kala) Astrit Avdyli Balliu, ka bashkëpunuar me disa shtetas turq, dhe pjesëtarë të disa grupeve të tjera kriminale, për të transportuar opiumin nga Turqia në drejtim të Brenogës. Pasi të përpunohej në laboratorin e saponduar, droga do të transportohej përmes portit të Durrësit në Gjermani, ku do të shpërndahet në disa qytete. Dyshohet se për të garantuar transportin do të jepte ndihmesën e tij, Lulzim Berisha. Por, në shtëpinë e ish-kreut të bandës së Durrësit, që u kontrollua në bazë të një vendimi gjyqësor, nuk është gjetur asgjë e paligjshme. Ndërkohë, grupi kriminal Avdylaj, dyshohet se në bashkëpunim me të



Lul Berisha

aferm të ish-deputetit të PS-së, Arben Ndoka, ka mundur të trafikojë sasi të mëdha hashashi. Bëhet fjalë për dy episode, ku sasi të drogës njëra 700 kg dhe tjetra 1 ton e 300 kg janë bllokua në brigjet italiane. Sipas burimeve të prokurorisë për Krime të Rënda, grupi Avdylaj, bashkëpunonte me disa persona të tjerë në Pier e Sarandë, për të trafikuar drogë. Në total janë 13 raste trafiku që kanë mundur të realizojnë, ndërsa po përgatishnin edhe pesë ngarkesa të tjera për të trafikuar. Mësohet se grupi kriminal, që ka në krye Jasin e Astrit Avdylaj (rezultoi të ketë edhe dy miemra të tjerë, Balliu e Sulejmanin), ndikonin

pranë zyrtarëve të lartë publikë apo njerëzve të politikës, për çështje të ndryshme. Teksa prokuroria po hetonte Avdylaj dhe bashkëpunëtorët e tyre, në rrjetën e përgjimeve ra pak muaj më parë Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Arben Çuko, i cili me nisjen e hetimeve ndaj tij u shkarkua nga detyra. Ai dyshohet se mori si rryshfet shumë prej 3 mijë eurosh, për transferimin e të dënuarit Olsi Karagozini e njohur si Olsi i Qamille. Për transferimin e këtij të dënuarit, tek ish-deputeti i PS, Çuko dyshohet se ka ndërhyrë Altin Avdyli, i njohur me nofkën Nicja. Edhe Arben Ndoka, ish-deputet socialist i lar-



Ish-deputeti Arben Ndoka



Ish-deputeti Arben Çuko

guar nga Parlamenti për shkak të ligjit të dekriminalizimit, është përgjuar teksta fliste me pjesëtarë të bandës Avdylaj. Në këtë mënyrë, prokuroria ka grumbulluar prova për të ngritur ndaj Ndokës, akuzën për ushtrimin ndikim në për tjetërsimit të pronave në Lezhë e Kurbin, në kuadër të një grupit kriminal. Hetimi për grupin në fjalë nisi në dhjetor 2016 nga prokurori Anton Martini. Ndërkaq, nga hetimet ka rezultuar se biznesmeni Admir Hoxha ka drejtuar ngritjen e laboratorit të drogës në Has. Kjo në bashkëpunim me disa anëtarë të arrestuar të grupit kriminal nga Shijaku.

Sipas Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Admir Hoxha ka mbajtur kontakte me H. Hoxhën, Saimir Gjepalin që të dy nga Shijaku me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike. Mësohet se Admir Hoxha ka në pronësi një hotel në Rinas. Ai është shpallur në kërkim nga policia, por nuk dihet nëse është brenda vendit apo është larguar. Goditja e grupit kriminal u bë menjëherë pas ndërhyrjes së autoriteteve gjermane dhe vjen në kohën kur në këtë shtet mbahet nën arrest biznesmeni Arbër Çekaj, i dyshuar për trafikimin e sasisë rekord prej 613 kg kokainë nga Kolumbia drejt Portit të Durrësit.



Operacioni për kapjen e Balilit, pranga kushëririt Abedin Kuçi

**SARANDË** - Një ditë pas dështimit të operacionit në Sarandë për kapjen e Klement Balilit, mësohet se një tjetër 'peshk' ka rënë në rrjetën e policisë. Bëhet fjalë për 49-vjeçarim Abedin Kuçi (kushëri i Balilit), i cili u kap në fshatin Stjar. Mësohet se Kuçi ka qenë anëtar i të ashtuquajturit "Grupi i Stjarit" i famshëm në vitin 1997. Ai është arrestuar në vitin 2016 për trafik droge, por u la i lirë. Po kështu Kuçi u shoqërua para disa muajsh nga policia e Gjirokastrës për verifikim pasi dyshohej sërish për trafik droge dhe përsëri i shpëtoi prangave.



Arrestimet gjatë megaoperacionit të koduar "VOL-VO 4"

TIRANË

**P**olicia e Shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda dje kanë dhënë zyrtarisht shifrat e megaoperacionit që u zhvillua në disa rrethe të vendit. Gjatë konferencës për shtyp, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu si dhe prokurorja e Krimeve të Rënda, Donika Prela bënë me dije se gjithsej janë lëshuar 44 urdhër arreste për 4 grupe kriminale, ndërsa janë arrestuar 27 persona si dhe 6 të tjerë janë ende në kërkim. Gjatë superoperacionit të koduar "VOL-VO 4", u godit grupi i laboratorit të heroinës në Has, grupi i Shijakut, ndërsa janë arrestuar edhe dy ish-deputetët e PS-së, Arben Noka dhe Arben Çuko, që dolën nga përgjimet e grupit kriminal të Avdyllajve. Për laboratorin e heroinës në Has janë arrestuar 5 persona, ndërsa 4 janë shpallur në kërkim. Grupi kriminal trafikonte kokainën në Gjermani dhe disa vende të Europës. Ndërkohë që përsa i përket grupit të Shijakut, janë arrestuar 19 persona për trafik droge dhe pastrim parash. Grupi i Shijakut drejtohet nga Astrit Avdyli, ndërsa në pranga kanë rënë edhe vëllezërit e tij dhe disa anëtarë të bandës. Ata akuzohen se kanë trafikuar heroinë në disa vende, ndërsa Prokuroria ka siguruar provat. Në kërkim për rastin e grupit të Shijakut është edhe Lul Berisha, ish-kapo e bandës së Durrësit. Ndërkaq, gjatë operacionit për goditjen e katër grupeve kriminale janë arrestuar edhe tre efektive policie. Nga ana tjetër, Prela paralajmëroi arrestime të tjera, pasi u shpreh se nga hetimet ka rezultuar se janë përfshirë në korrupsion disa institucione lokale, nga hipoteka, të bashkia, prefektura dhe institucione të tjera për të cilët vijojnë hetimet.

**DEKLARATA E POLICISË**

Policia e Shtetit nën drejtimin e Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe në bashkëpunim me agjenci të tjera ligjzbatuese kanë finalizuar përgjatë orëve të fundit një megaoperacion të koduar "VOL-VO 4", të shtirë në 12 qytete, nga Hasi deri në Sarandë, ku janë goditur anëtarë nga 4 grupe të skeduaruara kriminale, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Forcat policore, RENE, FNSH, ato operacionale në bashkëpunim me Drejtoritë Vendore të Policisë kanë ushtruar kontroll në qytetet Shkodër, Has, Lezhë, Shijak, Elbasan, Durrës, Fier, Vlorë, Tiranë, Patos, Sarandë dhe Delvinë. Gjatë këtij megaoperacioni janë arrestuar 27 shtetas dhe 6 u shpallën në kërkim. Gjithashtu, u godit një laborator i përpunimit të heroinës në fshatin Brenog në Has, ku ndër të tjera janë sekuestruar 182.5 kg morfina, e ndarë në 175 pako, 22 litra lëndë e

"Forca e Ligjit" goditi në 13 rrethe të vendit. Në pranga, edhe 3 efektive të implikuar

# Megaoperacioni, 27 persona të arrestuar për heroinën në Has dhe grupin e Shijakut

*Policia e Prokuroria: Goditëm 4 grupe kriminale, në total janë lëshuar 44 urdhër arreste*



Ardi Veliu dhe Donika Prela, gjatë konferencës për shtyp



Një nga të arrestuarit gjatë operacionit



**Trafiku i drogës, mes të arrestuarve**

**edhe mundësi Elis Guri**  
Një nga 27 personat e arrestuar nga policia në kuadër të megaoperacionit të shtirë në 12 qarqe të vendit është edhe një sportist. Bëhet fjalë për mundësin Elis Guri nga Shkodra, i cili është në listën e personave të arrestuar nga policia për veprat penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" si dhe "Trafikim i narkotikëve". Elis Guri u kap në Shkodër. Është një sportist shqiptar i mundjes klasike në peshën 96 kg. Suksesi i tij më i madh shënohet së pari në Kampionatin Europian që u zhvillua në Finlandë, ku Guri u shpall fitues i medaljes së bronzit në peshën 96 kg. Por dhe në Kampionatin Botëror 2007, ai klasifikohet i 7-ti në peshën 96 kg, duke fituar të drejtën e përfaqësimit me kualifikim në Lojërat Olimpke "Pekin 2008". Si pjesëmarrës për herë të parë në një olimpiadë, Guri renditet në vendin e 8-të, duke shënuar dhe rezultatin e dytë më të mirë të arritur nga kuqeziqinjtë tanë. Të tjera rezultate të Gurit mund të përmendim vendi i 7-të në Lojërat Mesdhetare "Almeria 2005", medalje argjendi në turneu botëror trefoq "Milone 2006". Pas vitit 2008, Elis Guri garon për Bullgariinë dhe me 13 shtator 2011 merr medaljen e arit në Kampionatin Botëror të Mundjes në kategorinë 96 kg.

**MEGAOPERACIONI I KODUAR "VOL-VO 4"**

**LABORATORI I HEROINËS NË HAS PERSONAT E ARRESTUAR**

1. Vehbi Berushi, 57 vjeç
2. Flamur Çela, 48 vjeç
3. Xhevit Shuti, 48 vjeç
4. Mustaf Shuti, 76 vjeç
5. Anila Shuti, 42 vjeç

**PERSONAT NË KËRKIM**  
2 shtetas turq, 1 kosovar dhe 1 shqiptar.

**PERSONAT E ARRESTUAR PËR TRAFIK DROGE E GRUP KRIMINAL**

1. Jasin Kala, alias Jasin Avdyli, me pseudonimin "Cine", nga Shijaku.
2. Shkëlqim Avdyli, me pseudonimin "Kiçi", nga Shijaku.
3. Denis Lafiut, nga Shijaku.
4. Fatos Lafiut, nga Shijaku.
5. Hajri Seferi, nga Shijaku.
6. Petro Kuçi, alias Abedin Kuçi, nga Delvina.
7. Ilirjan Priti, nga Fieri.
8. Elton Shehaj, nga Tirana.
9. Armand Spiro, nga Tirana.
10. Astrit Balliu, alias Avdyli, Sulejmani, me pseudonimin "Tit", nga Shijaku.
11. Altin Avdyli, me pseudonimin "Niçja", nga Shijaku.
12. Saimir Gjeçepali, nga Shijaku.
13. Gjevi Ndoka, alias Xhevahir, me

- pseudonimin "Xhevi", nga Lezha.  
14. Esat Mehmeti, me pseudonimin "Çakja", nga Fieri.  
15. Saimir Sulejmani, nga Fieri.  
16. Orges Jahaletzi, alias Artan Elezi, me pseudonimin "Nita", nga Tirana.  
17. Elis Bahushi, nga Elbasani.  
18. Elis Guri, nga Shkodra.  
19. Artur Balla, nga Elbasani.

**PERSONAT NË KËRKIM**  
M.Z. dhe P.S.

**POLICËT E ARRESTUAR**

1. Ardit Gjyriqi, nga Tirana.
2. Jasin Abdul, nga Saranda.
3. Bledar Koçi, nga Lushnja.

**ARMËT DHE MATERIALET E SEKUESTRUARA**

- 3 pistoleta.
- 3 armë gjahu, çifte dhe fishekë.
- 1 "Shotgan".
- Presë për lëndë narkotike të llojit heroinë.
- Peshore elektronike.
- Sasi lëndë narkotike heroinë e kokainë.
- 13 mjete, njëri i blinduar.
- Sasi e konsiderueshme parash.
- Rreth 75 telefona celularë.

lëngshme, të cilat përdoren për prodhimin e heroinës. Procedimi për këtë operacion ka nisur pas një referimi të Policisë së Shtetit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Gjatë kësaj periudhe, veçanërisht me intensitet në muajt e fundit, për dokumentimin e kësaj dosjeje, janë përdorur metoda speciale të hetimit. Në këtë procedim penal janë me mijëra orë përgjime, filmime, përgjime ambientale, vëzhgime me dron, mijëra faqe me shkresa dhe këmbim informacioni e korrespondencë me agjenci ligjzbatuese brenda e jashtë vendit.

Goditja e kësaj veprimtarie kriminale është bërë në periudha të ndryshme, duke u finalizuar këtë fundjavë. Në goditjen finale morën pjesë rreth 1.500 forca policore operacionale, FNSH, RENE dhe nga efektive të policia lokale. Në datë 18 tetor në mëngjes u ushtrua kontroll në banesën e shtetasit Mustaf Shuti në fshatin Brenogë, Has, ku u gjetën prekursorë për prodhimin e lëndës narkotike. Të arrestuar në flagrancë janë 5 shtetas për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikim i narkotikëve", "Prodhimi

dhe fabrikimi i lëndëve narkotike", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatë kriminale. Bëhet fjalë për Vehbi Berushi, 57 vjeç; Flamur Çela, 48 vjeç; Xhevit Shuti, 48 vjeç; Mustaf Shuti, 76 vjeç dhe Anila Shuti, 42 vjeç. Ndërsa u shpallën në kërkim 4 persona: 2 shtetas turq, 1 kosovar dhe 1 shqiptar. Në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda janë ekzekutuar vendime penale në disa qytete, si dhe janë ushtruar rreth 100 kontrolle banesash dhe

ambientesh të tjera. Të arrestuar për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikim i narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatë kriminale, si dhe pastrim i produkteve të veprës penale janë 18 persona, ku bën pjesë grupi i Shijakut, që kryesohet nga Astrit Avdyli, i njohur me pseudonimin "Cine". Gjithashtu, u shpallën në kërkim 2 shtetas M.Z., dhe P.S. Në kuadër të këtij megaoperacioni, ku u goditën këto 4 grupe kriminale, është zbuluar edhe implikimi i 3 punonjësve të Policisë së Shtetit. Ata akuzohen për veprat penale "Shpërdorim detyrë", "Ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufijve", në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatës kriminale. Efektivët e arrestuar janë Ardit Gjyriqi, nga Tirana; Jasin Abdul, nga Saranda dhe Bledar Koçi, nga Lushnja. Ndërkohë, në kuadër të këtij procedimi janë arrestuar më herët edhe 12 persona për vepra të ndryshme penale që lidhen me fushën e narkotikëve. Gjatë kontrolleve të ushtruara u sekuestruan 3 pistoleta; 3 armë gjahu, çifte dhe fishekë; 1 "Shotgan"; presë për lëndë narkotike të llojit heroinë; peshore elektronike; sasi lëndë narkotike heroinë e kokainë; 13 mjete, njëri i blinduar; sasi e konsiderueshme parash dhe rreth 75 telefona celularë. Policia e Shtetit, nën drejtimin e prokurorisë po vijon veprimet për të zbardhur rolin dhe aktivitetin e tyre apo personave të tjerë të lidhur me ta.

## ARRESTIMET REAGIMET

Kreu i PD: Peshqit e vegjël që kanë arrestuar do lirohen, akuzat do u lehtësohen

# Basha kërkon arrestimin e Dakos: Peshku i madh, të tjerët cironka

"Dosja po mbyllet edhe për 4 deputetë të PS-së"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha bën thirrje për arrestimin e 'peshqve të mëdhenj' pasi sipas tij të arrestuarit janë peshqit e vegjël të cilët shumë shpejt do të lirohen nga burgju. Ndaj arrestimet e 24 orëve të fundit për Lulzim Bashën janë skenar i Prokurorës së Krimeve të Rënda, Donika Prela për të prishur dosjen hetimore pas së cilës ai thotë se fshihet "Peshku i Madh". Lideri i PD-së shprehet se të arrestuarit në 24 orët e fundit janë 'peshq' të vegjël, pasi sipas Bashës, 'peshku' i madh është kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako. Sipas tij, duke iu servirur opinionit publik dhe partnerëve ndërkombëtarë disa peshq të vegjël po tentohet të mbyllet hetimi për peshkun e madh Vangjush Dako dhe për të paktën 4 deputetë të tjerë socialistë. "Dosja hetimore mbi të cilën është vepruar përgjysmë është dosja hetimore e Vangjush Dakos, peshku i madh është Vangjush Dako të cilin e kam paralajmëruar dy vjet se është kapur në flagrancë në përgjime zyrtare të prokurorisë dhe partnerëve në transaksione politike dhe financiare me krimin e organizuar. Kjo është një nga dosjet që ka marrë përsipër të shkatërrojë Donika Prela ndaj kjo është përpjekje për të shkatërruar dosjen e Dakos", deklaroi z.Basha. Në pragat e policisë, shprehet ai, kanë rënë cironka, teksa paralajmëron edhe lirimin e ish-zyrtarëve socialistë. "Peshqit e vegjël që kanë arrestuar mbrëmë do lirohen, akuzat do u lehtësohen. Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj bashkë me Donika Prelën, e cila ka qenë prokurore në Durrës po bëjnë gjithçka që hetimi për Vangjush Dakon të degjenerojë në arrestimin e përkohshëm të disa ish-deputetëve dhe disa cironkave të tjera", - u shpreh kreu i PD-së. Z.Basha njoftoi se pjesë e dosjes hetimore janë edhe katër deputetë socialistë, për të cilët sipas tij Prokuroria e Krimeve të Rënda me urdhrë të kryeministrit Rama po tenton të njiëtin skenar si me kryebashkiakun e Durrësit, Vangjush Dako "duke iu servirur opinionit publik dhe partnerëve ndërkombëtarë disa peshq të vegjël, që të mbyllet hetimi për Dakon dhe për të paktën 4 deputetë të tjerë socialistë.



Kreu i opozitës Lulzim Basha

### "Qindra kilometra regjistrime për kryeministrin"

Berisha: Në përgjimet e Italisë, qeveritarët me bandën 'Avdylaj' dhe 'Ndokaj'

Për ish-kryeministrin Sali Berisha, pas operacionit policor që çoi në arrestimin e anëtarëve të familjes Avdylaj dhe ish-deputetit Arben Ndoka, qëndrojnë agjencitë ligjzbatuese gjermane e italiane. Berisha shprehet në 'Fb' se pikërisht këto agjenci, 'shkatërruan bandën e partisë siciliste dhe të Noriegës'. "Agjencitë e zbatimit të ligjit të Gjermanisë dhe Italisë goditën bandën e famshme elektorale të qeverisë, Avdylaj, klanin kriminal Ndoka të Lezhës të lidhur ngushtë me Ramën, Gjushin, dy ministrat e Gjushit në narko-kabinetin Rama, ndriku Nikollën e deputetin Ndreu, si dhe 18 narkokomisarë, narkooficerë policie etj., etj.", theksoi ai. Berisha përmend se në dosjet e ardhura nga Italia e Gjermania ka me qindra kilometra regjistrime për kryeministrin Rama, kreun e Bashkisë së Durrësit Vangjush



Dako, për ministra, deputetë e të tjerë. "Në dosjet e ardhura nga Italia dhe Gjermania ka qindra kilometra regjistrime bisedash që provojnë lidhjet kokë e këmbë me bandën e famoze të trafikut të drogës Avdylaj dhe narkoklanin Ndokaj të vetë Noriegës, Gjushit, dy ministrave të Gjushit në narkokabinetin Rama, ndriku Nikollës, deputetit Ndreu, si dhe 18 narkokomisarëve dhe narko-policëve të narkopolicisë", u shpreh z.Berisha. Ai dënon dekonspirimet e këtyre operacioneve, ashtu sikurse



#### KLANET

Ish-kryeministri Berisha dënon dekonspirimet e operacioneve të policisë, ashtu sikurse mbrojtjen që po i bëhet sipas tij, kupolës politike të klaneve të goditura dhe lidhjet e tyre në nivele të larta.

mbrojtjen që po i bëhet sipas tij, kupolës politike të klaneve të goditura dhe lidhjet etyrene në nivele të larta. "Duke shprehur mirënjohjen për të gjithë ndihmën e çmuar të agjencive të vendeve partnere dhe dënuar me forcë dekonspirimet e këtyre operacioneve nga narkokomisarë dhe narko-qeveritarë, dënoj, gjithashtu, mbrojtjen që po i bëhet kupolës politike të klaneve të goditura dhe lidhjeve të tyre me nivelet më të larta të politikës", tha z.Berisha.

Përpjekje propagandistike për ta shfrytëzuar dosjen Dako me arrestimin e disa peshqve të vegjël ose të ngordhur", - deklaroi kreu i opozitës Lulzim Basha.

Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Policia e Shtetit dhanë djete shifrat e bilancit të operacionit që u realizua në tre ditët e fundit në 12 qytete të vendit nga veriu në

jug. Gjithsej janë lëshuar 44 urdhrë arreste për katër grupet kriminale, ndërsa janë ekzekutuar 27 dhe 6 të tjerë janë ende në kërkim nga policia.

#### AKUZA

"Vangjush Dako kryesori, të tjerët janë peshq të vegjël për të shpëtuar peshkun e madh të kësaj dosjeje, Vangjush Dakon, dhe për të shkatërruar prova të tjera. Kjo është një nga dosjet që ka marrë përsipër të shkatërrojë Donika Prela. Peshqit e vegjël do lirohen, akuzat do lehtësohen. Është pjesë e skenarit të prokurorisë", - u shpreh kreu i PD-së.



Gjatë një seance parlamentare



### "Emra ministrash të përfshirë në përgjime"

Paloka: Po kapen peshqit e vegjël që të mbulojnë të mëdhenjtë

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka duke marrë shkas nga ndalimet e fundit të zyrtarëve e ish-zyrtarëve të institucioneve publike si dhe goditjen e grupeve kriminale, theksoi se Rama po tenton që të heqë vëmendjen nga vetja. I ftuar në 'News24' Paloka tha se po kapen 'peshqit e vegjël' që të mbulojnë të mëdhenjtë. Po ashtu ai foli edhe për një dosje përgjimi që është që prej 2016-ës në Prokurori, ku implikohet sipas tij kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako që sipas opozitës flet me ekspertët të kriminit për shit-blerje votash. Paloka tha se kjo dosje po tentohet të fshihet. "Është dosja në prokurori që mban numrin 339, e vitit 2016. Është kjo dosje që kanë nisur përgjimet e Dakos. Nuk janë të njëjtat çështje. Kjo dosje u denoncua nga zoti Basha dhe më pas ka pasur u dërgua padia nga Dako në gjykatë për kryetarin e PD, ku ai e akuzoi për shpifje. Hilja që ka bërë këtë herë prokuroria është se e ka fshehur këtë dosje", - theksoi z.Paloka. Ai njoftoi se ka edhe emra ministrash të përfshirë në përgjime. "Gjiknuri dhe Arben Ahmetaj dalin në komunikime me elemente kriminale në shitja-blerjen e votave. Kanë dosje të tjera, nuk është e njëjta dosje. Bëhet fjalë për zgjedhjet e 2017-ën. Janë të faktuar. Shpërrthimi i kësaj dosje nuk vjen as nga vullneti e dëshira e Ramës. Është DEA dhe Gjermania që erdhi dhe e detyroi këtë qeveri që të veprojë. Rama po përpiqet që të shpëtojë kokat. Kjo betejë e Ramës bëhet për të shpëtuar këta elementë që përmendja dhe veten e tij. Historia e kësaj dosjeje nuk ka mbaruar. Ata që e kanë nxitur këtë dosje, s'kanë mbaruar punë. Ka një bazë amerikane sigurie në gjermani ku shumë deputetë, kanë zhvilluar kurse ku jepet edhe informacion. Që prej 2015-ën kam qenë aty, ku flitej për kthim të Shqipërisë në një të kokainës", - tha z.Paloka.



Kryeministri replikon me Bashën për sulmet ndaj prokurorisë: Shpif, shpif se lirohesh

# Rama: Një tjetër superoperacion, të fortët do vihen në rresht

*"Na kanë nxirë fytyrën, thirrja për socialistët"*

Kryeministri Edi Rama paralajmëroi pasditen e djeshme se aksionet e policisë do të vijojnë deri në kapjen e "të fortit" të fundit. Gjatë një takimi me gratë dhe vajzat në Laprakë, kryeministri bëri të qartë se këta personazhe do të vihen në rresht. Task-Forca speciale e Policisë së Shtetit mesa duket është duke zhvilluar një tjetër operacion të madh për të goditur grupet kriminale në vend. Kryeministri bëri me dije se pritet që Policia e Shtetit ditën e sotme do të njoftojë për rezultatet e një tjetër operacioni masiv në kuadër të "Forcës së Ligjit". Kreu i qeverisë foli ndër të tjera për të ashtuquajturit "të fortë", për të cilët tha se nuk do të ekzistojnë më. "Do të jem shumë të ashpër me të fortët. Nesër (sot) besoj publiku do të njihet me rezultatet e një tjetër operacioni që është në vijim. Lufta me të fortët do të vazhdojë deri sa i forti i fundit të kuptojë se nuk ka të fortë në këtë vend, pasi del nga shtëpia, i fortë është komuniteti. Ne do t'i detyrojmë o të vihen në rresht dhe të respektojnë ligjin e këdo qoftë, ose ka vetëm një vend për ta, aty ku shkuan sot ata që janë brenda. Historia që një lagje e tërë shqetësohet pse ky fis na ka makina e muskulaturë të zhvilluar, do të mbarojë në këtë vend. Këto janë sjellje që prej vitesh kanë fituar një lloj qytetari si ato ndërtimet pa leje që janë të palegalizueshme. Në këtë aspekt dua t'i siguroj të gjithë qytetarët që shteti do të jetë në krah të tyre", u shpreh kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me banorë të Laprakës.



Kryeministri Edi Rama

**PARALAJMËRIMI**

"I forti ta kuptojë se s'ka të fortë në këtë vend. Do t'i vëmë në rresht. Ka vetëm një vend për ta, aty ku shkuan sot, dhe aty ku do të shkojnë të gjithë ata që s'u binden rregullave. Këta fiset që kanë makina e muskulatura të zhvilluara do të mbarojnë në këtë vend. Kjo është histori që vazhdon prej vitesh, tabjate që kanë fituar qytetari, si ndërtime pa leje. Shteti do të jetë në krahun e çdo qytetari", deklaroi z.Rama.

Vasili nxjerr dokumentet: Arta Marku i mbyll çështjen vetes dhe Ramës

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së Petrit Vasili sulmoi dje kryeprokuroren e përkohshme Arta Marku si dhe kryeministrin Edi Rama. Vasili tha se i njëjti prokuror mbylli çështjen e Ramës për autopërgjimin si dhe atë për "shpërdorim detyrë" sipas tij ndaj Arta Markut. Vasili e cilësoi këtë fakt një "komedi e zezë". "Arta Marku i mbyll çështjen vetes me te njëjtin prokuror si Ramës, çfarë turpi!" Arta Marku i mbyll fët e fët çështjen vetes. I njëjti prokuror që mbylli çështjen Edi Ramës për manipulimin dhe mashtrimin nëpërmjet ekspertizës së audiopërgjimit të Agron Xhafajt mbylli sot me të njëjtin zell dhe shpejtësi edhe çështjen e Arta Markut e akuzuar për shpërdorim detyrë. Kjo është drejtësia e "re" e neveritshme, që do të thotë burg për të gjithë, me dhe pa të drejtë të mbyllje e çdo zullumi me ligjin për kryeministrin dhe për kryeprokuroren, që i shërben atij. Këta i bëjnë qoka mbylljeje çështjesh njerëzjesh dhe turpi është sheshit. Kush e beson më këtë drejtësi nuk ka më asnjë respekt për veten. Ja vendimi me i fundit që i mbyll çështjen Arta Markut, çfarë komedie... e zezë...", u shprehet z.Vasili



Arrestimet në Lezhë, deputeti i PS: U veprua në mënyrë skandaloze

Deputeti i PS-së Pjerin Ndreu reagoi dje në mbledhjen e grupit parlamentar socialist në lidhje me operacionin e policisë në Lezhë. Ai shprehet me rezervë në lidhje me mënyrën e veprimit të policisë dhe prokurorisë, ndërsa e quan skandaloze mënyrën e arrestimit. Sipas tij në këtë rast është vepruar me dy standarde. "Nuk marr përsipër të gjykoj provat. Kam rezervë për mënyrën skandaloze të veprimit, sjelljen skandaloze dhe se si kanë vepruar me mënyrën e arrestimit dhe praktikimin e dy standardeve, një grup që quhet i parëndësishëm dhe merret prokuroria lokale dhe një grup tjetër që merret prokuroria e Krimeve të Rënda. Duhet të shihen me qetësi këto gjëra. Ne si forcë politike nuk mbështesim asnjë veprim të paligjshëm, por mënyra e të proceduarit të prokurorisë dhe policisë në dy raste të ndryshme në Lezhë është e habitshme. Të presim verdiktin e drejtësisë e të flasim për të tjerat", deklaroi z.Ndreu.

**BE mirëpret operacionin e policisë**

Operacionet masive, ambasadori Soreca: Luftë krimin dhe drogës



**DEKLARATA**

"Ne mirëpresim operacionin masiv të ndërmarrë sot në disa qytete nga policia e Shqipërisë. Të luftojmë kundër krimin të organizuar dhe trafikimit të drogës në Shqipëri është prioritet i BE. Presim që ndjekjet penale dhe dënimet të vazhdojnë me rezultate të qëndrueshme" - tha z.Soreca.

arrestoi të dielën dy ish-deputetë, si dhe disa prej anëtarëve të të ashtuquajturave "të fortët" e Shijakut. Një operacion i gjerë u ndër-

mor edhe për arrestimin e Klement Balilit, i konsideruar si "Eskobari i Ballkanit", ndonëse kapja e tij nuk u bë e mundur.

që s'e ka marrë vesh se sulmet vulgare ndaj prokurorisë vijjnë nga dhimbjet e forta të kokës për çështjet e hapura me drejtësinë! Lufta me krimin e me korrupsionin vetëm do të përkallëzohet" shkruan Rama në Twitter. Arrestimet e bujshme të dy ish-deputetëve socialistë nuk u

përmenden nga kryeministri Rama, në mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar me këto fjalë grupit parlamentar: "Kemi disa drejtorë duke u nxirë fytyrën duke u përfshirë në korrupsion e keqmenaxhim. Performanca e tyre është larg prishmërisë së publikut".

# QEVERISJA AKUZAT

Deputetja e PD denoncon rritjen e taksave: Shtrenjtimi, për një sërë produktesh

Valentina Madani

Nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, deputetja demokratike, Jorida Tabaku deklaroi se çmimi i shtrenjtë i karburanteve në Shqipëri vjen për shkak të taksave. Ajo shprehet se në këto 5 vite qeveria ka rritur taksat për një sërë produktesh dhe nuk ka bërë asnjë investim. "60% e çmimit sot është taksë. Në 2014, qeveria Rama shtoi me 240 lekë taksën e qarkullimit, që sot bën të kemi karburantin më të shtrenjtë në Europë dhe rajon", lexohet në postimin e Tabakut. Deputetja shtoi: "Rriti me 24% çmimin e energjisë elektrike. Rriti me 33% çmimin e biletës së urbanit. Rriti me 30% çmimin e ujit të pijshëm. Rriti me 30% tarifat e arsimit të lartë. Dyfishoi çdo taksë, uli konsumin, uli pagat, rriti çmimin e në këmbim nuk bëri asnjë investim! Këto janë fakte që propaganda si mohon dot. Sot çmimi i karburantit dhe çdo gjë tjetër që kushin më shtrenjtë është dhuratë e qeverisë Rama". Edhe më herët nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku akuzon qeverinë për rritjen e çmimit të naftës. Ajo e lidh shtrenjtimin me taksat dhe tarifat e vendosura për karburantet. "Qytetarët sot paguajnë naftën më shtrenjtë se në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi apo dhe Zvicër. Shtrenjtimi i çmimit të naftës nuk është vetëm pasojë e rritjes së çmimit të naftës bruto në bursë, por është një investim personal i qeverisë, e cila duke vendosur një shumëllojshmëri taksash dhe duke rritur tarifat e tjera kanë ndikuar në rritjen e çmimit", shprehet deputetja e PD-së. Tabaku bën edhe një krahasim me vendet europiane. "Sipas të dhënave të 'Global Petrol Prices', ne paguajmë për një litër naftë çmimin e 184.03 lekë/litër, ndërkohë që një belg paguan 183.53 lekë/litër, një zviceran 182.51 lekë/litër, një kroat 178.36 lekë/litër". Zj.Tabaku krahason taksat mbi karburantin në vitin 2013, të cilat ishin 47.17%, ndërsa në vitin 2018 arrijnë në 60% të çmimit. "Sipas saj, e vetmja rrugë për uljen e çmimit të naftës është një politikë e re fiskale, që mbron dhe stimulon konsumin.

# PD, Tabaku: Qeveria rriti taksat pa bërë asnjë investim

## "60% e çmimit të karburantit është taksë"



Nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, deputetja demokratike, Jorida Tabaku

### TAKSA

Jorida Tabaku, deputete e Partisë Demokratike, u shpreh dje se, "karburanti në Shqipëri ka më shumë taksë se në çdo vend të botës. 60% e çmimit sot është taksë. Në 2014, qeveria Rama shtoi me 240 lekë taksën e qarkullimit, që sot bën të kemi karburantin më të shtrenjtë në Europë dhe rajon", - shprehet Tabaku.

Foto ilustruese



### Berisha bashkëbisedon me deputetët gjermanë, mbështetës të opozitës iraniane

Ish-kryeministri Sali Berisha priti dje në zyrën e tij një delegacion deputetësh gjermanë, mbështetës të opozitës iraniane, një pjesë e së cilës gjenden e strehuan në Shqipëri. "Në takim shpreha falënderimet dhe mirënjohjen për qeverinë gjermane, për të gjithë ndihmën e dhënë përgjatë këtyre viteve të ndërtimit të demokracisë dhe proceseve integruese. Thesova se procesi i afrimit të vendit tonë në BE duhet të bazohet mbi vlera, të cilat ne duhet t'i ndërtojmë. Në këtë kontekst u shpreha se Gjermania ka treguar mbështetje dhe ndihmë ndaj Shqipërisë dhe se ka mbajtur një qëndrim objektiv dhe të drejtë. Por shpreha keqardhjen që Komisioni Europian në raportet e tij ka paraqitur një realitet të lustruar, duke mos folur me një gjuhë të hapur në mbrojtje të vlerave. Në takim shpreha gjithashtu falënderimet për fondacionin 'Konrad Adenauer', për të gjithë angazhimin e tij shumëvjeçar në mbështetje të proceseve demokratike në Shqipëri dhe qeverinë gjermane, e cila ka ruajtur ndaj Shqipërisë një interes të palëkundur e shumë të madh. Janë me qindra projektet e ndërtuara nga veriu në jug të vendit tonë nga qeveria gjermane me fonde të taksapaguesve gjermane që kanë pasur ndikim të rëndësishëm në Shqipëri. Takimi ishte i hapur", deklaroi z.Berisha.



### Balla në inaugurimin e shkollës, Pollo largohet nga ceremonia

Kryetari i Komisionit të Integritimit, deputeti demokrat Genc Pollo u largua nga ceremonia e inaugurimit të Shkollës Europiane si shenjë proteste ndaj pjesëmarrjes në këtë ceremoni të të akuzuarit për lidhje kriminale, Taulant Balla. Pollo u largua sapo Balla mori fjalën në ceremoni, duke e refuzuar fjalimin e numrit dy të Partisë Socialiste, i cili së fundmi është akuzuar për lidhje me eksponentët e rekorde kriminale. Një javë më parë, Pollo denoncoi edhe në KE, kryetarin e grupit socialist duke i numëruar publikisht akuzat për lidhje kriminale. Këto akuzë u bënë bashkëshoqëruar me kërkesën e deputetëve të PD që bëjnë pjesë në Komitetin Parlamentar të Asociim Stabilizimit, Shqipëri-BE, për të larguar nga bashkëdrejtimi të këtij organizimi Taulant Ballën. Pollo në këtë mbledhje depozitoi edhe prova, tashmë të bëra publike që tregojnë implikim e Ballës me eksponentët të kriminit.

### ILIR META

Presidenti Ilir Meta u nis dje për një vizitë shtetërore në Austri, me ftesë të homologut të tij Alexander Van der Bellen. Kreu i shtetit do të pritë gjatë kësaj vizite me ceremoni zyrtare nga presidenti austriak, me të cilin do të ketë bisedime kokë më kokë si dhe në krye të delegacioneve respektive dypalëshe. Gjithashtu, Presidenti Meta do zhvillojë takime me autoritetet e larta të Austrisë.

### SHKURTE

### Vendet vakante, PS dorëzon 2 kandidatët e saj për KQZ-në

Partia Socialiste ka gati 2 kandidatura për anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bledar Skënderi, i cili do të ripropozohet për një mandat tjetër dhe Rezarta Bitri, janë përzgjedhur për t'u dorëzuar zyrtarisht Kuvendit. Aktualisht janë 4 anëtarë të këtij institucioni që iu ka përfunduar mandati. Veç Skënderit, këtë muaj u përfundoi mandati 4-vjeçar dhe Gëzim Velešnjak, i propozuar nga LSI, si dhe 2 të propozuarve nga demokratët, Pranvera Shtjefnit dhe Hysen Osmanajt. Por opozita duket se nuk e ka në krye të axhendës së saj politike përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KQZ, sa kohë që ajo po e zhvillon betejën e saj jashtë parlamentit.

### Ekselentët që zgjedhin mësuesinë, qeveria 1000 USD në vit bursë

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje një takim me mësuesit ekselentë. Në fjalën e tij Rama u shpreh se të gjithë studentët e ekselencë do të marrin bursa rreth 1000 dollarë. Po kështu asnjë student nën 7 nuk do futen në degën e mësuesisë... "Mbështetje financiare për ekselentët që kanë zgjedhur mësuesinë - Jo vetëm NUK do paguajnë tarifë studimi, por do marrin edhe një BURSE rreth 1000 USD në vit. Vendosja e mesatares mbi 7 për hyrjen në mësuesi, e ka bërë këtë vit akademik momentin e një kthesë të madhe në rrugën e të ardhmes së mësuesisë", - deklaroi kryeministri Edi Rama.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZRYA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA NR. 2/694-2-14, LLOJTI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.900.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Dyqan", me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 516, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k. lënë si garanci hipotekore për Bankën Tiranë s.h.a me Kontratë Hipotekore Nr. 1201 Rep., Nr. 80023 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 48,082 Euro.

- Ankandit për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 31.10.2018.

Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**ZRYA PERMBARIMIT GJYQESOR KORCE**

**1-Me date 01.11.2018**,diten e Enjte ora 16.00 perfundon ankandit i pare per pasurine: (Apartament) me nr.pasurie 4/267+1-2,zk.8662,vol.1,fq.227 me sipërfaqe prej 52 m<sup>2</sup> regjistruar në Z.V.R.P.P. Korce, e ndodhur në adresën Lagjia nr.4,Rr: Todi Vlogji/pallati nr.4,Shk.a.K.4,Korçe

**2-Cmimi fillestar me te cilin fillon ankandit eshte 1.360.000 lekë.**

Ankandit zhvillohet ne ambientet e Zyrës se Permbarimit Korçe Me adrese Bulevard "Republika" Keshilli Qarkut,Kati 4, Korce tel.082245621



'Bastet', të enjten në Kuvend. Rama: Pas lotove, radhën e kanë lokalet që shesin alkool për fëmijë

# "Lojërat e fatit", PD: Paratë e bixhozit po hidhen në ndërtim

PS: Krimi pastron paratë përmes bixhozit

**K**omisioni i Ekonomisë pritet të diskutojë sot ndryshimet ligjore të ligjit për lojërat e fatit. Paralelisht me Komisionin e Ekonomisë jashtë dverve të Kryesisë së Kuvendit është njoftuar një protestë e punonjësve që rrezikojnë të mbeten të papunë si pasojë e mbylljes së lojërave të fatit. Ndërkohë ditën e enjte ligji do të kalojë në Kuvend me procedurë të përshpejtuar. Ligji për bastet dhe ai për shpifjen ishin kryefjala e mbledhjes së socialisteve. Mësohet se kryeministri Rama ka porositur deputetët të mos mungojë asnjë në seancën e së enjtes ku do të votohet ligji për lojërat e fatit. Po kështu Rama iu ka kërkuar ligjvënësve socialistë të denoncojnë çdo shpifje. E me sa duket për këtë të fundit maxhoranca ka ngritur një ekip avokatësh për ta ndjekur ligjërisht. "Ligjin për lojërat e fatit do ta votojmë me shumicë dhe është i lutur çdo deputet t'i bashkohet votimit. Të gjithë duhet të jeni në seancën e së enjtes për të votuar ligjin për lojërat e fatit. Asnjë të mos mungojë në seancën e së enjtes. Po kështu do ju kërkoja që të gjithë të denoncojnë çdo shpifje duke firmosur dhe kaq ka ekipi që e ndjek", mësohet se jetë shprehur z.Rama në mbledhjen e grupit. Por gjatë një takimi me gratë në Llaprakë pasditen e djeshme kryeministri Rama deklaroi se bixhozi në Shqipëri finançohet në një masë të madhe nga krimi i organizuar dhe përmes tij pastrohen paratë. "Sipas studimeve, lojërat e fatit janë faktor kryesor për vetëvrasjet. Në një masë të madhe biznesi i basteve finançohet nga burime kriminale" - tha z.Rama. Ai përmendi se: "Pas tre ditësh besoj se parlamenti do ta votojë për të mbyllur çdo debat për t'i dhënë fund atij lumit të baltës dhe



**INA ZHUPA**

"Kompanitë e lojërave të fatit po investojnë në fushën e ndërtimit. Rasti i fundit është ajo i 'Apex', i cili i ka shitur aksionet. Partia Demokratike po publikon shifjen e aksioneve në vlerë 500 mijë euro. Me tërheqjen nga lojërat e fatit, biznesmeni do të përqendrohet në ndërtim. Dajlan Avdija ka në pronësi dy kompani ndërtimi. Me firmën e Ramës dhe Veliajt, ai ka marrë leje ndërtimi për 3 kulla gjigante", - tha z.Zhupa.

## Kompanitë e basteve: Bashkëpunim me qeverinë, jo mbyllje të menjëhershme

**K**ryeministri Edi Rama ka lajmëruar mbylljen e kazinove dhe basteve sportive nga viti i ardhshëm, ndërkohë që kompanitë e basteve sportive në një konferencë për shtyp shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse duke parashtruar disa kërkesa, të cilat, sipas tyre, do të zbatohen në 2019. Kryetari i shoqatës së basteve sportive Artan Shyti thotë se industria e lojërave të fatit do të minimizojë në maksimum reklamën pranë veprimtarive të tyre, do të respektojnë distancat 100 metra largësi nga institucionet arsimore, ndërsa premtojnë se deri në 2019 do të reduktojnë në 50 % numrin e pikave të basteve. "Deri më sot kemi operuar në bashkëpunim me shtetin për ta sjellë deri në këtë nivel bastet sportive, prap se bashku të punojmë për të cur në ato drejtime dhe ato nivele ligjshmërie institucionale këtë aktivitet në Republikën e Shqipërisë", u shpreh Shyti. Në rast se nuk do të gjejmë mirëkuptimin e qeverisë, operatorët thonë se beteja do të jetë ligjore në gjykatë. Sipas tyre, bëhet fjalë për biznes të ligjshme me licenca 10-vjeçare. "Janë biznese të ligjshme të licencuara për një periudhë 10-vjeçare kanë konsumuar as 1 të 3 e licencës së tyre dhe është normale që në një shtet që mbron lirinë e pronës, lirinë e aktivitetit lirinë e biznesit në momentin që nuk ka mirëkuptim dhe bashkëpunim çështja që nuk ka rrafshin gjyqësorë", deklaroi z.Shyti.



**NJOFTIM**

**Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k.** propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORCA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e licencuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjës Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjësja Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** ne sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**

në Shqipëri. Një nga aksionerët e kësaj kompanie, Dajlan Avdija, ka shitur aksionet e tij pak kohë përpara se Rama të deklaronte mbylljen për disa kategori të lojërave e fatit. Partia Demokratike po publikon sot për herë të parë kontratën e shitjes së 16 % të aksioneve prej rreth 500 mijë euro nga klienti i Edi Ramës tek partneri i tij austriak i APEX-it. Me tërheqjen nga biznesi i lojërave të fatit, aktiviteti i Dajlan Avdisë do të përqendrohet në ndërtim, një fushë tjetër që nga Departamenti Amerikan i Shtetit konsiderohet si mjet kryesor për pastrimin e parave të pista të kimit dhe korrupsionit", deklaroi zëdhënësjja e PD-së. Ina Zhupa përmendi se: "Dajlan Avdija ka në pronësi dy kompani të mëdha ndërtimi, "Techno Alb" dhe "Invest Society". Në emër të këtyre dy

shpifjeve lidhur me këtë çështje. Është fatkeqësi që një numër i madh fëmijësh, bien prap e këtij vesi. E kanë filluar lojërat e fatit afro 70% e tyre në moshën 10-15 vjeç".

**OPOZITA**

Demokratët për mes zëdhënëses, Ina Zhupa akuzuan dje se kompanitë e bixhozit të lidhura me kryeministrin Rama po investojnë para në fushën e ndërtimit. Sipas saj, biznesmeni Dajlan Avdija ka në pronësi dy kompani ndërtimi dhe me ndihmën e Ramës dhe të kreut të bashkisë, Erjon Veliajt, ai ka marrë leje ndërtimi për tri kulla gjigante. "Kompanitë e bixhozit, klientët të Edi Ramës, po i investojnë paratë e bixhozit në fushën e ndërtimit me lejen e Edi Ramës. Rasti më flagrant është ai i kompanisë APEX, kompania më e madhe e bixhozit

kompanive, Edi Rama dhe Erion Veliajt kanë dhënë disa leje ndërtimi në dy nga zonat më të shtrenjta të kryeqytetit - në qendër të Tiranës dhe në zonën e ish-Bllokut". Sipas saj me firmën e Edi Ramës dhe të Erion Veliajt, biznesmeni i bixhozit Dajlan Avdija brenda 7 muajsh ka marrë leje për tri kulla gjigante: njëra në nëntor 2017 në zemër të Bllokut, një tjetër në shkurt të këtij viti tek Kulla e Sahatit. "Për kullën e tretë leja u dha në muajin qershor, pak pasi klienti i Edi Ramës shiti aksionet e bixhozit. Kjo kullë do të ndërtohet mbresa presidencës. Lejet e ndërtimit për biznesmenin e madh të bixhozit janë një provë flagrante të mbështetjes së Edi Ramës për transferimin e veprimtarisë së pastrimit të parave nga bixhozi tek ndërtimi", theksoi zëdhënësjja e PD-së.

United Nations Development Programme



**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

**Post Title:** Public Relation & Communication Assistant  
**Duty station:** Tirana  
**Duration of Assignment:** 1 year with possibility of extension  
**Type of Contract:** Service Contract

**Educational Background:** University graduate in journalism, media and communications or other relevant, preferably with significant exposure to human rights, development matters, or equivalent  
 Possessing of a master degree in one of the above areas would be an additional asset.

**Work Experience:** At least 5 years, of progressively responsible experience in PR and media relations; Proven skills to draft communications strategies on behalf of international, national organizations and or private sector.  
 Must possess a solid understanding of local governance issues. Ability to work in a pressured environment with strict deadlines;

**Demonstrated understanding of Albania's local governance system.**  
 Experience in integrated governance programming / institutional development.

**Tentative Starting Date:** 15 November 2018  
**Deadline for Application:** 01 November 2018

**Job Description:** Available at UNDP site:  
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

Drejtori i Përgjithshëm i Transportit Rrugor, Arben Isaraj, ka dhënë dorëheqjen nga posti pas arrestimit të vëllait të tij një natë më parë. Në letrën drejtuar ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri, Isaraj shkruan se jep dorëheqjen për të mos ndikuar në hetimet ndaj të vëllait, për shkak të pozicionit të tij. "Për të mos ndikuar direkt apo indirekt, me pozicionim tim të lartë administrativ, në pavarësinë dhe



Drejtori i Transporteve, Arben Isaraj

"Për të mos ndikuar në dhënien e drejtësisë"

## I arrestuan vëllain, jep dorëheqjen drejtori i Transporteve, Arben Isaraj

dhënien e drejtësisë në Shqipëri, jap dorëheqjen nga pozicioni i drejtorit të përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor", - thuhet në letrën drejtuar ministrit të Transportit, Damian Gjikhuri.

Burime për "BalkanWeb" bëjnë me dije se Altin Isaraj akuzohet për veprën penale "Armëmbajtje pa leje" dhe "Prodhim dhe shitje të narkotikëve". Kujtojmë se ish-zëvendësministri i Drejtësisë, Arben Isaraj është emëruar

vitin e kaluar drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, duke zëvendësuar në këtë detyrë Ylli Spahiu nga radhët e LSI. Emërimi i Isaraj në këtë detyrë erdhi nga kryeministri Edi Rama.

Vrasja te Blloku/ Lihet në qeli i plagosuri. Avokati: Nuk ka prova, duhet të lirohet

# Gjykata e Apelit lë në burg Ervis Martinajn

Avokati i Elion Hatos: Nuk u pranuan kërkesat për masat e sigurisë

TIRANË

Gjykata e Apelit ka dhënë masën e sigurisë arrest me burg për Ervis Martinajn. Ky i fundit ishte prezent në vrasjen e 4 tetorit në zonën e ish-Bllokut. Trupa gjykuese duke shqyrtuar të gjithë dinamiken e ngjarjes, nuk ka pranuar kërkesën për liri të bërë nga Martinaj. Pas vendimit ka folur për mediat edhe avokati, i cili deklaroi se nuk ka prova që e implikojnë Martinajn në vrasjen e Bllokut. Ai shtoi se klienti i tij nuk është i përfshirë në këtë vrasje dhe pretendimet se Redi Poposku ka fshehur armën e Martinajt i ka quajtur thjesht aludime. "Nuk rezultoi të këtë ndonjë provë, sado të vogël, që mund ta lidhë të mbrojturin prej meje me ngjarjen e 4 tetorit. Ndalmimi ishte në pjesën për t'i dhënë prokurorisë kohë për



I arrestuari, Ervis Martinaj



Vendi ku ndodhi ngjarja

të bërë ca prova. Në hetimet e gjykatës përkatësisht definicioni dhe konkluzioni i disa akteve të ekspertimit kompjuterike dhe balistike. Nëse prokuroria nuk bën kërkesë tjetër për një masë

arresti, natyrisht që do të lirohet automatikisht. Nuk ka mundësi që të provohet fakti që mund të kishte armë, sepse nuk ekziston ky fakt, sepse nuk ka pasur armë në lokal", tha avokati i Ervisit,

Mirash Martini. Avokati të plagosurit tjetër, Elion Hatos, tha para mediave se kërkesat e parashtruara prej tij nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit. "Atë që kërkojmë ne nuk e pranuan.

Nuk janë kushtet dhe rrethanat për shkak të rëndësisë së ngjarjes dhe nuk është e përshtatshme kërkesa që bëjnë në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit të Gjykatës së Rrethi Gjyqësor Tiranë", u shpreh Zeni Qinani, i cili është avokati i Elion Hatos. Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në zonën e ish-Bllokut, Gjykata e Tiranës dha masën e sigurisë "arrest me burg" për 30 ditë ndaj tij. Vrasja që tronditi opinionin publik ndodhi mbrëmjen e 4 tetorit në një nga zonat më të frekuentuara të Tiranës, në Bllok. Në këtë ngjarje mbeti i vrarë Fajbiol Gaxha, ndërsa Martinaj së bashku me Elion Haton mbetën të plagosur. Ndërkohë, të përfshirë në këtë ngjarje ishin edhe Redi Poposku, pronar i lokalit ku ndodhi vrasja; komandoja Mervjoll Bilol, Ervin Mata, Fajbol Alushin si dhe këngëtarja e njohur Elvana Gjata.

DYSHIMET



Gomonia e përmbytur në Vlorë, shoqërohen dy të dyshuar

VLORE - Një gomone e përmbytur është gjetur pranë ishullit të Sazanit në Vlorë. Informacionet e para nuk flasin për drogë, por dyshohet se gomonia do përdorej për trafik. Gjithashtu, mësohet se deri tani policia ka shoqëruar 2 persona në komisarjat, të cilët do të merren në pyetje. Gazetari Enrik Mehmeti raportoi për "BalkanWeb" se në gomone kanë qenë 3 persona, 2 shqiptarë dhe një italian. Nuk dihet nëse njeti është përmbytur për shkak të motit të keq dhe detit të trazuar. Policia ka nisur hetimet për zbardhjen e ngjarjes. "Në orën 23:40, anija 'P - 112 Skënderbeu' e Forcës Detare, njoftohet nga QNOD në lidhje me një skaf qe po mbytej. Menjëherë anija e Forcës Detare është nisur në vendngjarje ku ka konstatuar skafin e mbytur. Në bashkëpunim me Guardia di Financia është bërë i mundur shpëtimi i 3 personave", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

NGJARJA

Lëndë plasëse makinës së administratorit të Farkës

TIRANË - Mjeti i administratorit të njësies Farkë ka rënë pre e një sulmi me lëndë plasëse. Ngjarja në fjalë ndodhi rreth orës 02:00, në rrugën e "Tufajev" në Lundër. Burime zyrtare nga policia bëjnë me dije se mjeti në pronësi të shtetasit me inicialet A.T. pësoi dëme të vogla materiale në pjesën e pasme të tij. Deri më tani nuk dihen rrethanat se si ka ndodhur ngjarja, si dhe motivet e saj. Ndërkohë, policia po punon për identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

## Akuzohen për vepra të ndryshme penale, 3 të arrestuar në Vlorë

VLORE - Policia e Vlorës ka arrestuar tre persona, pasi akuzohen për vepra të ndryshme penale. Në pranng ka përfunduar Lorenc Kananaj, 44 vjeç, me akuzën për kundërshtim dhe kanosje të punonjësve të policisë, Redian Metaj, 35 vjeç me akuzën për dhunë ndaj bashkëjetueses së tij si dhe Artur Ago, 47 vjeç i dënuar me 3 muaj burg për kallëzim të rremë. Njoftimet e policisë për tre të arrestuarit:

"Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasin

Lorenc Kananaj, 44 vjeç, banues në Vlorë. Arrestimi i tij u bë pasi më datë 21.10.2018 dyshohet se ky shtetas ka kundërshtuar me dhunë punonjësën e policisë së patrullës së përgjithshme, duke e kano-



sur atë për shkak të detyrës. Materialet iu referuan prokurorisë për veprën penale 'Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik' dhe 'Kanosja për shkak

të detyrës', parashikuar nga nenet 236/2 dhe 238 të Kodit Penal.

Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasin Redian Metaj, 35 vjeç, banues në

Vlorë. Arrestimi i tij u bë pasi mëngjesin e datës 21.10.2018. Dyshohet se ky shtetas ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëjetueses së tij A.Sh., për motive të dobëta.

Materialet iu referuan prokurorisë për veprën penale 'Dhunë në familje', neni 130/a i Kodit Penal.

Policia ka bërë ndalimin e shtetasit Artur Ago, 47 vjeç, banues në Vlorë. Policia ka bërë ndalimin e tij, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 353, datë 13.07.2018, e ka dënuar këtë shtetas me 3 muaj burg për veprën penale 'Kallëzimi i rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal".



Patrulla e Përgjithshme, përgjigjet e testit me shkrim për fazën e parë

Policia e Shtetit ka publikuar dje listën e kandidatëve fitues për Patrullën e Përgjithshme të policisë, pas testimit të zhvilluar më 15 dhe 16 tetor në Pallatin e Kongreseve.

Sipas policisë, në fazën e parë të testimit me shkrim, ata që kanë marrë 50 pikë e sipër fitojnë të drejtën për të vijuar konkurrimin në fazën e dytë, në testimin fizik. Kandidatët fitues do njoftohen nga Drejtoritë Vendore të Policisë në qarqet ku kanë aplikuar si dhe në faqen zyrtare të Akademisë së Sigurisë dhe të Policisë së Shtetit për datën, orën dhe vendin ku do zhvillohet testimi fizik dhe çfarë duhet të kenë me vete për të zhvilluar testimin.

2500 konkurrenët në polici, kush kalon në fazën e dytë të garës

Kush ka mbi 50 pikë, do kryejë testin fizik

KONKURRNTËT NË POLICI

Table with 4 columns: NR, MBIEMRI EMRI, REZULTATI, and a list of names and scores. The table contains 110 rows of data.

Table with 4 columns: Name, Number, Name, Number. Lists names and their corresponding numbers in a grid format.

Table with 4 columns: Name, Number, Name, Number. Lists names and numbers in two columns, separated by a central vertical line.

Hapi më i rrezikshëm në jetë? Motor në autostradë pa patentë...

# Gjergji Kaçinari:

## Harxhoj pikën e fundit të zërit në performanca "live"

*"Jam shumë strikt, e shoh me shumë gjakftohtësi progresin dhe rezultatin"*

Egla Xhemali

Muzika që ngre peshë publikun është rroku. Për të, ajo është flakë e brendshme që shkrihet me tingujt e shpirtit. Gjergji Kaçinari, një nga këngëtarët më të dashur për publikun që prej netëve të "The Voice" vjen në një rrëfim për "Gazeta Shqiptare", për pasionin e tij më të madh dhe jetën përtej skenës. Kaçinari na thotë se ai di të shprehë më mirë me muzikë se me fjalë. Një dashuri e pandashme që nga fëmijëria, që do të jetë bashkudhëtare e tij kudo. Irritur me frymën e artit, Gjergji tregon se është strikt dhe e sheh me shumë kujdes rezultatin që japin provat në performancat 'live'. Një artist i mbushur me energji pozitive si ai, që di ta zotërojë skenën, nuk mund të mos ketë kaluar edhe momente të sikletshme gjatë netëve në performanca, por që kordat e tij nuk kanë zhgënjyer kurrë deri në fund. Më tej mes të qeshurash, artisti ndan me ne hapin më të rrezikshëm që ka ndërmarrë në jetë. "The Voice" që një rrugëtim që i ndryshoi rrjedhën e gjithçkaje. Kaçinari nuk ndjen lodhje, pasi ai e do fort profesionin dhe pasionin e tij.

### Sa shpirt ke në tinguj?

Unë kam nisur muzikë më parë se të mësoja të flisja dhe mendoj se është gjëja që di të bëj më mirë e se di më mirë të shprehem me muzikë se me fjalë.

### Çfarë muzike e ngre peshë publikun?

Definitivisht, mbarë botërisht, historikisht, muzika rok.

### Si janë çastet pas provave të performancave 'live'?

Provat janë pjesa ime e preferuar. Jam shumë strikt dhe e shoh me shumë gjakftohtësi procesin, progresin dhe rezultatin.

### Celësi i të qenit gjithmonë energjik?

Sigurisht, një regjim i mirë dhe aktivitetet fizike, por pasioni kryeson gjithmonë.

### Momenti më i sikletshëm në skenë?



Kur kordat nuk të binden. Këshilla më e shpeshtë që dëgjon nga prindërit? Mos u merr me budallallëqe.

### Cila është mënyra përmes të cilës një femër mund të lexojë drejt?

Ka plot mënyra por "të përshtëndes me këtë këngën" mbetet kali i betejës.

### Në retrospektivë, si ka qenë fëmijëria jote?

Shumë intensive. Përveç shkollës, aktivitetet fizike kanë zënë pjesën më të madhe të kohës. Studimi i pianos, si edhe veglave të tjera që sajoja me mjete rrethanaore ka qenë bonus.

### Hapi më i rrezikshëm që

### ke ndërmarrë deri më sot?

Motor në autostradë pa patentë (qesh). Ka pasur plot raste, ku pritsmëritë e ulëta janë bërë shkak për këdo të më ndalë vullin që marr kudo, edhe atëherë kur hapi i "pasigurt" do mund të ndryshonte rrjedhën e gjithçkaje (siç që "The Voice"), por fatmirësisht rrallë ndikoheh nga jashtë.

### Çfarë do të thotë "të jetosh si të jetë dita e fundit"?

Për mua, nga ana profesionale, do të thotë të "harxhosh" edhe pikën e fundit të zërit në çdo performancë "live" dhe kjo tek unë ndodh

"literally" gjithmonë.

### Përtej punës, çfarë raportesh ke me jetën e natës?

Nuk e kam frekuentuar asnjëherë rregullisht dhe me vullnet të plotë. Edhe në kulm të adoleshencës, më kanë tërhequr gjithmonë mbrëmjet e qeta, ndonjë gotë verë a birrë dhe pa turma e zhurma përreth.


### Projekti që ke në duar momentalisht?

Projektet individuale dhe me grupin (Kaçinari) do të mbeten gjithmonë këngë të reja, shoqëruar me video klipe, si edhe performancat e koncertet 'live'.




## Dafina Zeqiri bën ndryshimin e papritur, zbuloni çfarë ka bërë ajo

Është e preferuara e publikut dhe për këtë nuk ka dyshime. Veçse është një prej këngëtareve më të mira shqiptare që ka sjellë një frymë tjetër me këngët e saj. Dafina Zeqiri bën revolucion dhe me stilin e saj të veçantë e të pakrah-sueshëm. Së fundmi, Dafina ka zbuluar ndryshimin që ka bërë në trup dhe mund të themi se kemi mbetur gojëhapur. Nëpërmjet disa fotove të postuara në "Instagram", Dafina e shtrirë në shtrat ka ekspozuar tatuazhin e saj që mbulon thuasje të gjithë këmbën. Tashmë e ka konfirmuar që nuk trembet aspak të guxojë me eksperimentet e saj.




## Era Istrefi "djeg" rrjetin me foto provokuese

Ajo është shfaqur tejet provokuese në foton e fundit. Këngëtarja Era Istrefi në postimin e fundit të publikuar në "Instagram" duket seksi si asnjëherë më parë. Veç me sytjena, ajo ka zbuluar gjoksin ndërsa pranë fotos ka shkruar disa fjalë. "Më trego se të duhem". Ka kohë që emri i Erës po vazhdon të jetë kryesues në mediat rozë, shqiptare dhe jo vetëm.




## Flori Mumajesi bëhet baba për herë të parë?

A tëherë kur menduam se Flori Mumajesi po largohej nga skandalet e showbizit, një lajm i bujshëm na vjen nga pornostarja me origjinë shqiptare, Albyn Rydes. Burime të sigurta për emisionin "SevenBizz", kanë zbuluar se ylli i filmave për të rritur, me prejardhje shqiptare, Alby Rydes, po pret fëmijën e kantautorit të njohur. Ndërkohë artisti i njohur me emrin Loco, me anë të një postimi ka uruar Albyn, duke shkruar: "Urime Alby, dëshiroj gjitha t'mirat po a s'pate mashkull mat mire me gjet veç flori mumajesi me ta fry barkun a". Epo, krismat u dëgjuan...tani mbetet të zbulojmë nëse ajo që dëgjuam është e vërtetë.



## Lori Hoxha braktis Shqipërinë, ja ku do jetojë bukuroshja

Lori Hoxha është një prej vajzave më të komentuar të showbiz-it. Por, duket se së fundmi, Lori ka vendosur të "braktisë" Shqipërinë për të jetuar diku tjetër. Fillimisht menduam se Lori vizitoi Londrën vetëm për të festuar ditëlindjen e saj, por nëpërmjet "Instastori" ajo ka zbuluar për të gjithë ndjekësit se ajo tashmë do të nisë një jetë të re në Londër. Lori publikoi disa prej dhuratave që kishte marrë prej mikeshave të saj, ndërsa njëra prej tyre i përmendte shtëpinë e re: "Gëzuar ditëlindjen Lor. Të gjes një dhuratë për ty është shumë e vështirë, pasi ti pothuajse ke gjithçka. Shpresoj që bluza të të mbajë ngrohtë, vëhët të të duken mirë dhe mendoj se do të të duhet dhe një varëse për çelësat e shtëpisë tënde të re. Të dua." - ishte shënimi i mikeshës të cilin Lori e ndau me të gjithë në Instastoryn e saj, duke lënë të kuptohet se tashmë do të zhvendoset në Londër.





Maqedoni/ Votuan ndryshimet kushtetuese, deputetët nën mbrojtje policore

# Kamenos: Do qëndrojmë derisa të shkojë 'thika në palcë'

Ministri i Brendshëm maqedonas: U kërcënuan me jetë

**E**dhe pse ende nuk po mbush një javë nga largimi i ministrit të Jashtëm, Kotzias, një tjetër ministër paralajmëron largimin nga kabineti qeveritar. Ka qenë pikërisht ministri grek i Mbrojtjes Panos Kamenos, i cili ka paralajmëruar largimin nga qeveria, nëse kryeministri Tsipras dërgon në parlament marrëveshjen e Prespës për emrin e ri të Maqedonisë. Me tone të ashpra kundër marrëveshjes, ai foli gjatë kongresit kombëtar të Grekëve të Pavarur në Selanik. "Qëndrimi ynë në qeveri do të jetë derisa të shkojë 'thika në palcë', pra deri kur marrëveshja të paraqitet në parlamentin e Greqisë. Ne do ta braktisim atë seancë dhe do të largohemi nga qeveria". Megjithatë, Kamenos nuk nënkupton krizë politike deri në zgjedhjet parlamentare të vitit të ardhshëm. "Qeveria nuk do të bjerë. Do të vazhdojmë ta mbështesim qeverinë deri në mars të vitit të ardhshëm, siç kemi rënë dakord me kryeministrin Tsipras. Viti 2019 është vit zgjedhor." Grekët e pavarur kanë qenë gjithmonë kundër çdo marrëveshjeje me Shkupin që në emrin e ri shtetëror përmban termin "Maqedoni". Në të njëjtën linjë është edhe opozita e kryesuar nga Demokracia e Re. Për miratimin e marrëveshjes në parlamentin grek nevojitet një shumicë prej 3/5-tash ose 180 deputetë. Pa mbështetjen e Kamenosit, Tsipras i nevojiten 5 deputetë për të arritur edhe shumicën e thjeshtë. Nga ana tjetër, në Maqedoni, tetë deputetët e opozitës të cilët votuan pro ndryshimeve kushtetuese janë



Ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kamenos

**PANOS KAMENOS**

"Qëndrimi ynë në qeveri do të jetë derisa të shkojë 'thika në palcë', pra deri kur marrëveshja të paraqitet në parlamentin e Greqisë. Ne do ta braktisim atë seancë dhe do të largohemi nga qeveria", - ka thënë ministri Kamenos.

nën mbrojtje 24-orëshe, ngaqë vazhdimisht marrin kërcënime përmes shkrimeve në rrjetet sociale. Ministri i Brendshëm i Maqedonisë Oliver Spasovski ka theksuar se ka dyshime për një strukturë të organizuar që qëndron pas kërcënimeve. "Bëhet fjalë

## Kërcënojnë ta vrasin, reagon kreu i Komunës së Mitrovicës

**AGIM BAHTIRI**  
"Kam marrë një e-mail kërcënues ku kërkohet vdekja ime dhe po ju them të gjithëve se mesazhet e tilla nuk çojnë askund. Agim Bahtiri s'ka kush në botë që e frikëson... Nga ana e serbëve... Mesazhi për qytetarët e mi është që të rrinë të qetë dhe të mos brengosen fare, sepse kryetarin s'ka kush që e frikëson", - ka shkruar Bahtiri.  
Rastin e kam lajmëruar në polici, policia, hetuesia kanë ardhur menjëherë dhe janë duke gjurmuar... Kjo, përmendet edhe në mesazh, ndërlihet me urën... Unë do t'i çoj proceset përpara pa ndalur asnjëherë dhe... nuk do të ketë askush që mund ta ndalojë procesin e hapjes së urës... Ura do të hapet shumë shpejt... Mesazhi për qytetarët e mi është që të rrinë të qetë dhe mos të brengosen fare, sepse kryetarin s'ka kush që e frikëson", - ka shkruar Bahtiri.

për një grup të caktuar të afërt me iniciativën "Bojkotoj", që kërcënon me jetë deputetët, familjet e tyre etj. Për deri sa ekzistojnë kërcënime të tilla ata do të sigurohen". Zhvillimet e fundit në gjirin e VMRO-DPMNE-së pritet të jenë në qendër të vëmendjes së

mbljedhjes së Komitetit të saj Qendror të thirrur për në orën 19:00. 'Kja' e tetë deputetëve dhe vota 'për' fillimin e ndryshimeve kushtetuese duket se ka acaruar tej mase fërkimet në udhëheqjen e partisë më të madhe opozitare në vend. Sipas medias në Sh-

**SHKURT**

**Conte: Italia është BE e do japim kontributet**

Kryeministri italian Giuseppe Conte ka hedhur poshtë zërat se Italia nuk pranon të dialogojë me BE mbi reformën fiskale të sapo aprovuar. Në takimin e tij të parë me gazetarët e huaj në Itali, Conte informoi se i ka nisur një letër zyrtare Brukselit ku konfirmon bashkëpunimin me institucionet europiane. Shkak është bërë dekreti fiskal i sapo aprovuar nga qeveria por që ndërsa pritej të mbërrinte në zyrën e Presidentit të Republikës, dikush i ka ndryshuar tekstin. Kryeministri italian ka kërkuar menjëherë tërheqjen e tekstit të manipuluar duke pezulluar draftin fiskal deri në rishikimin nga ana e tij të të gjitha nenëve.

**Selfie në Auschwitz, turistët rrezikojnë burgun**

Tri adoleshente rrezikojnë burgun pasi bënë selfie duke përsëndetur me krahuin shtrirë, e ngjashme me përsëndetjen e nazizmit. Vajzat ishin në një ekskursion shkollor në kampin e Auschwitz në Poloni, kur në hyrje bënë foton selfie dhe e postuan në Instagram. Vajza, e cila kishte postuar foton pasi e kuptoi efektin që shkaktonte fotoja e hoqi nga Instagram-i, e megjithatë autoritetet polake arritën t'i identifikojnë vajzat adoleshente të cilat rrezikojnë dhe burg. "Një selfie e tillë është tronditëse dhe e tmerrshme. Edukimi dhe ndjeshmëria ndaj fatit tragjik të të gjitha viktimave të Auschwitzit janë shumë të rëndësishme"-ka thënë Bartosz Bartyzel, zëdhënës i muzeut Auschwitz portali polak 'Ewpl'.

**Poloni/ Konservatorët fitojnë zgjedhjet, por humbin Varshavën**

Konservatorët në pushtet në Poloni kanë fituar zgjedhjet lokale në vend, por humbasin kolltukun të kryetarit të bashkisë së Varshavës, sipas sondazheve të para. Rafal Trzaskowski, kandidati i opozitës proBE, dominon ndaj rivalit Patryk Jaki, eksponent i "Ligi dhe Drejtësi" dhe njëkohësisht zëvendësministër i Drejtësisë i qeverisë konservatore të Mateusz Morawieckit. Sondazhi i ISPOS thotë se Rafal Trzaskowski, një ish-deputet, mori 51,4% të votave dhe do të bëhet kryetar i bashkisë së Varshavës pa pasur nevojë të marrë pjesë në balotazh më 4 nëntor. Në zgjedhjet për këshillat provinciale, partia "Ligi dhe Drejtësi" ka marrë mbështetje të lartë me 32,3%, sipas sondazheve të para. Zgjedhjet e së dielës ishin testimi i parë kombëtar i mbështetjes për partinë e "Ligi dhe Drejtësi", politikat e së cilës kanë shkaktuar protesta në rrugë dhe përplasjet të përsëritura me udhëheqës të Bashkimit Europian.

**Shkup/ Mbahet kongresi i tretë i Lidhjes Shqiptare në Botë**

## Bujar Osmani: Së shpejti, përkujtimorja në memorial të holokaustit shqiptar

**N**ë Shkup, në praninë e mbi 300 përfaqësuesve nga mbarë hapësirat shqiptare dhe bota, Lidhja Shqiptare në Botë ka organizuar Kongresin e tretë të saj. Me këtë rast është theksuar roli i rëndësishëm në zhvillimin e etnisë e në promovimin e identitetit etno-kulturor edhe përmes implementimit të projekteve që emërtohet të përbashkët kanë integrimin. Zëvendës-kryeministri Bujar Osmani, duke përsëndetur tubimin, ka paralajmëruar ndërtimin e një memoriali të holokaustit shqiptar në fushën e Sten-



kovencit ku më 1999 u gjetën dhjetëra mijëra shqiptarë të Kosovës si rezultat i dëbimit me forcë nga forcat usht-

arako-policore serbe. Linda Aliu ndoqi nga afër punimet e këtij tubimi. Simon Kuzhini, kryetar i LSHB-së potencoi rolin e Kongresit për, sikurse u shpreh ai, zhvillimin e etnisë e të promovimit të identitetit etno-kulturor, sidomos në përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të diasporës tek organet shtetërore në hapësirat shqiptare. Zv/ kryeministri për Çështje Evropiane Bujar Osmani, i cili në Kongres përfaqësoi BDI-në, nënvizoi se Shkupi paraqet simbolin më të mirë të për-

plekjes së brezave të patriotëve shqiptarë dhe të rajonit që të jenë pjesë e familjes euroatlantike. Me këtë rast, Osmani paralajmëroi se shumë shpejt në fushën e Stenkovencit, në afërsi të kufirit me Kosovën, do të ngrihet një qendër e madhe përkujtimore të cilën ai e quajti memorial i holokaustit shqiptar. Fjala është për lokalitetin, ku më 1999 u vendosën dhjetëra mijëra kosovarë, si rezultat i dëbimit me forcë nga forcat ushtarako-policore serbe. Në këtë tubim të Lidhjes Shqiptare

në Botë mori pjesë edhe Zv/kryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj. Ndërkohë, biznesmeni i njohur nga Tetova, Lazim Destani, në fjalën përsëndetëse, përgëzoi drejtuesit si dhe të gjithë aktivistët e kësaj shoqate për punën e bërë dhe arritjet, gjithashtu, si dhe inkurajoi që pandalshëm të kontribuohet për çështjen kombëtare sepse vetëm kjo është mënyra që ne si komb të zhvillohemi dhe ta arrijmë bashkimin. Në Kongresin e Tretë të Lidhjes Shqiptare në Botë morën pjesë mbi 300 delegatë e veprimtarë si dhe përfaqësues e personalitete të fushave të ndryshme - politika, biznesi, kultura e sporti.

## LOTARIA AMERIKANE KËSHILLAT E AMBASADËS

Sa më herët ta plotësoni formularin, aq më shpejt keni mundësinë për intervistë

# Lotaria Amerikane, ambasada: Mos jepni përgjigje për pyetjen nr.6

"Penalizimet, rishikoni të dhënat e aplikimit tuaj fillestar"

Voltiza Duro

Të interesuarit që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar kanë afat edhe 15 ditë për të aplikuar. Ambasada amerikane ditën e djeshme i ka bërë thirrje kandidatëve që të mos japin përgjigje për pyetjen 6, e cila konsiston në kualifikimin e Shqipërisë për këtë program. "Nëse keni lindur në Shqipëri, lini pyetjen 6 pa përgjigje", thekson ambasada. Ndërkohë në udhëzimin e Departamentit Amerikan të Shtetit bëhet me dije se vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë nuk lidhet me vendin ku jeton aplikanti. "Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë - Nëse keni lindur në Shqipëri, nuk ka nevojë t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje. Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë normalisht do të jetë i njëjtë me atë të lindjes. Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë nuk lidhet me vendin ku jetoni. Nëse keni lindur në një vend jo të kualifikueshëm për Programin e Lotarisë, lutemi rishikoni Pyetjet të Shtruara Shpesh për të parë nëse ka mënyrë tjetër që mund t'ju bëjë të kualifikueshëm", thuhet në udhëzim.

### KRITERI I ARSIMIMIT

Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së. Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë që është i barasvlefshëm me arsimimin në të paktën një shkollë të mesme amerikane (4 vjeçare, me kohë të plotë, arsim i përgjithshëm). Diplomat e shkollës së mesme gjimnaz me kohë të plotë kualifikohen për lotarinë. Shkollat e mesme profesionale me kohë të plotë mund të kualifikohen nëse ato në thelb përputhen me kërkesat thelbësore të një të arsimi të mesëm me kohë të plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendimi përfundimtar do të merret nga oficeri konsullor në ditën e intervistës për vizë. Diplomat e shkollës së mesme me kohë të pjeshme - pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose ato me korrespondencë, përfshirë programet pesë vjeçare ose programet e gjata (me



### KRITERI

Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së. Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë, që është i barasvlefshëm me arsimimin në të paktën një shkollë të mesme amerikane (4-vjeçare, me kohë të plotë, arsim i përgjithshëm).

kohë të pjeshme, pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose me korrespondencë) nuk kualifikohen për programin e lotarisë. "Edhe nëse ju keni mbaruar një pjesë të shkollës së mesme në sistemin pa shkëputje nga puna dhe pjesën tjetër në sistemin me kohë të plotë, kjo diplomë nuk kualifikohet për programin e lotarisë", thotë ambasada. Diplomat universitare kualifikohen për programin e lotarisë së DV-së.

### KRITERI I PUNËSIMIT

Aplikantët që nuk përm-

bushin kriterin e arsimimit, duhet të përmeshin kriterin e përvojës në punë për dy vjet në një profesion që kërkon të paktën dy vjet trajnim apo përvojë brenda një periudhe pesëvjeçare menjëherë para aplikimit. Vetëm disa profesione specifike kualifikohen për programin e Vizave të Shumëllojshmërisë. "Për t'u kualifikuar për një vizë të lotarisë mbi bazën e eksperiencës së punës, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion

që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në Përgatitjen Profesionale Specifike (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart", thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

### PËRZGJEDHJA

Për ata që kanë aplikuar për Programin e Lotarisë DV-2020, njoftimi zyrtar i përzgjedhjes do të kryhet drejtpërdrejt nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit (Entrant Status Check). Kjo është e vetmja mënyrë me të cilën do të merret njoftimi i statusit të aplikimit. "Nëse ju merrni një njoftim me anë të postës elektronike apo me postë rreth përzgjedhjes suaj në lotarinë E-DV, duhet të dini që ky njoftim nuk është i ligjshëm. Vetëm pasi ju të jeni përzgjedhur, pasi t'ju jeni përgjigjur udhëzimeve të njoftimit të mundësuar për ju nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit, si dhe pasi të ketë filluar shqyrtimi i rastit tuaj, vetëm atëherë ju mund të merrni në vazhdim e-maile komunikimi nga QKK-ja që ju njofton juve të shikoni Kontrollin e Statusit të Aplikimit për informacione të reja rreth aplikimit tuaj. Për të përzgjedhurin e programit DV-2020, duhet të plotësojnë formularin elektronik DS-260. Sa më herët ta plotësoni formularin DS-260, aq më shpejt keni mundësinë e caktimit të datë së intervistës për vizë. Caktimi i datës së

### APLIKIMI

Përpara intervistës për vizë, aplikantët duhet të rishikojnë të dhënat që kanë dhënë në aplikimin fillestar për lotarinë. "Sigurohuni që të keni dhënë informacionin e saktë mbi statusin tuaj civil në momentin e aplikimit fillestar. Nëse ju ishit i/e martuar në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë, ju duhet të kishit përfshirë bashkëshortin/en tuaj në atë aplikim fillestar (edhe nëse keni qenë në proces divorci).

### APLIKIMI

Përpara intervistës për vizë, aplikantët duhet të rishikojnë të dhënat që kanë dhënë në aplikimin fillestar për lotarinë. "Sigurohuni që të keni dhënë informacionin e saktë mbi statusin tuaj civil në momentin e aplikimit fillestar. Nëse ju ishit i/e martuar në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë, ju duhet të kishit përfshirë bashkëshortin/en tuaj në atë aplikim fillestar (edhe nëse keni qenë në proces divorci). Përjashtim bëjnë rastet kur bashkëshorti është Nënshkruar Amerikan, ose Banor i Përhershëm i Ligjshëm. Gjithashtu, ju duhet të kishit përfshirë të gjithë fëmijët tuaj të pamartuar dhe nën 21 vjeç në momentin e aplikimit fillestar. Me fëmijë nënkuptohen fëmijët tuaj biologjikë, dhe thjeshtërit-fëmijët e bashkëshortit/es tuaj, apo fëmijë që i keni bërësuar ligjërisht, pavarësisht nëse jetojnë me ju ose jo. Sigurohuni që ju keni ngarkuar fotografinë e saktë për çdo pjesëtar të familjes në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë.

Ngatërrimi i fotografive në aplikimin fillestar do të rezultojnë në refuzimin e vizës për ju dhe familjen tuaj", thotë ambasada.

### PENALIZIMET

Mosdeklarimi i bashkëshortit/es ekzistues, apo i fëmijës ekzistues në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë do të rezultojnë në refuzimin e vizës. Çdo tarifë e paguar ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara për aplikimin për vizë nuk rimbursohet. Nëse në momentin e aplikimit fillestar, nuk keni përfshirë një fëmijë ekzistues, apo një bashkëshort/e me të cilën ishit i martuar (pra, statusi civil ishte "i martuar" në momentin e aplikimit fillestar), atëherë mos vazhdoni me procedurën e aplikimit për vizë.

### KUJDES NGA MASHTRIMET

"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi tuaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një mashtrimi. Vitet e shkuara, aplikantët fitues njoftoheshin nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK) me anë të postës, JO me e-mail dhe të përzgjedhurve u jepeshin udhëzimet se si të vazhdonin në hapat e mëtejshëm të procesit. QKK-ja nuk ju kërkoi juve t'u dërgoni para (të holla) atyre, apo ndonjë Ambasade tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A.) me postë apo nëpërmjet shërbimeve si Western Union", bën me dije ambasada. Vetëm aplikantët e përzgjedhur njoftohen nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK). Asnjë organizatë tjetër apo kompani private nuk është e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për të njoftuar aplikantët e DV-së për përzgjedhjen e aplikimit të tyre si fitues, apo të hapave të mëtejshëm në procesimin e aplikimit për vizë.



**Bizneset: Mbyllja për 6 muaj, zgjidhja më e mirë**

**Përfshirja në TVSH, bujtinat në zonën e Valbonës mbyllin aktivitetin**

Bujtinat në veri të vendit në zonën e Valbonës janë mbyllur. Vizitorë ka ende, por fluksi i lartë tashmë ka kaluar ndaj llogaritë nuk dalin pas përfshirjes në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Nga dhjetëra bujtina dhe hotelet në zonë aktualisht janë të hapura vetëm katër prej tyre që kanë kapacitet të lartë akomodimi. Disa nga administratorët e bujtinave të mbyllura thanë se nuk hapen para prillit-majit 2019, duke shpjeguar se do të konservojnë në status pasiv aktivitetin.

**BUJTINAT**

Nga dhjetëra bujtina dhe hotelet në zonë aktualisht janë të hapura vetëm katër prej tyre, që kanë kapacitet të lartë akomodimi. Disa nga administratorët e bujtinave të mbyllura thanë se nuk hapen para prillit-majit 2019, duke shpjeguar se do të konservojnë në status pasiv aktivitetin.

ergjisë, pagave të punonjësve dhe taksave të tjera" tha Astrit Selimaj banor i zonës i punësuar në një nga restorantet e Valbonës për Monitor. Ai tha se përfshirja në TVSh dhe aksioni i tati-meve për kuponin tatimor ku u vendosen disa gjoba

këtë vit i ka bërë bizneset me racionale në zgjedhjet e tyre. Për momentin zgjidhja më e mirë është mbyllja për 6 muaj. Si rezultat i kësaj gjendje turistët nga Tirana e kanë pasur të pamundur të rezervojnë, pasi shumica e bujtinave janë mbyllur edhe

pse koha për udhëtime është mjaft e favorshme. Më herët në verë të këtij viti në kumin e sezonit turistik, shumë bujtina janë penalizuar nga inspektorët tatimore me shumë se sa për taksat për disa rregulla që kanë të bëjnë me mjedisin dhe shërbimet mjekësore ndaj klientëve.

Një nga bujtinat mori gjobë se nuk kishte një kontratë me mjek, ndërkohë që numri i turistëve dhe punonjësve ishte shumë i ulët se kërkesat që ka ligji. Këto biznese e ushtrojnë aktivitetin në skajin më verior



të vendit në një terren që krijon kosto për aktivitetin e tyre. Largësia me institucionet e shtrembëron zbatimin e ligjit, ndoshta më shumë se kudo tjetër. Një nga hotelet është gjobitur për moslëshim kuponit, ndërkohë që në zonë nuk ka pasur

furnizimin me energji për më shumë se 12 orë. Larg gjykatave dhe pamundësive për të kërkuar drejtësi, ata kanë zgjedhur t'i vënë dryn aktivitetit deri në pranverë. Vite e tjera bujtinat ishin të hapura gjatë gjithë kohës.

**Autoriteti i Konkurrencës: Informacioni nga Ministria e Shëndetësisë, me mangësi**

**Nis hetimi për shërbimin spitalor, dyshohet për parregullsi në dializën e QSUT-së**

*"Do shqyrtohen koncesionet për tri vitet e fundit"*

Shërbimi spitalor është vendosur nën hetimin e Autoritetit të Konkurrencës, i cili do të shqyrtojë veprimtarinë e spitaleve për këto 3 vitet e fundit. Koncesioni i check-up dializës dhe sterilizimit, do të jenë në qendër të hetimit pasi është e vështirë të konkludohet për konkurrencën në shërbimin shëndetësor në drejtim të rritjes së cilësorisë së shërbimit dhe eficientës ekonomike pasi çështjet e trajtuara në studim, që lidhen me konkurrencën në sistemin e shëndetësisë, e lidhur me koncesionet në këtë sektor kanë nevojë për një trajtim më të thelluar dhe më gjithëpërfshirës. Studimi, sipas raportit të Konkurrencës u mbështet në gjetjet e raportit të ekspertit "Konkurrenca në Shërbimin Shëndetësor" dhe u fokusua në katër çështjet kryesore. Çështja e parë lidhet me konkurrencën në sektorin e shëndetësisë nëpërmjet rritjes së shërbimeve shëndetësore, e cila do të vlerësohet përmes indikatorëve makro të sektorit të shëndetësisë dhe kryesisht në shërbimin spitalor. Informacioni i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishte i mangët duke e bërë të pamundur vlerësimin e treguesve global të zhvillimit të konkurrencës në shërbimin shëndetësor. Ndërkohë çështja e dytë lidhej me politikat qeverisëse në sigurimin e shërbimit spitalor e fokusuar në konkurrencën mes shërbimit privat dhe shtetëror në drejtim të cilësorisë së shërbimit. Elementi kryesor në këtë analizë ishte vlerësimi i koncesioneve apo partneritetit publik/privat, duke analizuar llojet e shërbimeve të përfshirë në këtë formë shërbimi, efektet në nivelin e cilësorisë si dhe ndikimin që kanë sille në konkurrencën në treg këto kontrata. Nga analiza e informacionit të depozituar u konstatua se janë lidhur kontrata koncesionare për 3 shërbime: Koncesioni i Check-Up, me objekt "Për kontrollin mjekësor bazë 35-



70 vjeç nëpërmjet një seti analizash të miratuara si dhe vizita mjekësorë. Koncesioni "Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të

setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikal steril, furnizimin me materiale mjekësorë steril njëpërdorimshëm në sallat kiru-

rgjikale" dhe Koncesioni i Dializës, me objekt ofrimin e shërbimit të dializës sa më pranë vendbanimit të të sëmurit me insuficiencë re-

**INFORMACION**  
Informacioni i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishte i mangët, duke e bërë të pamundur vlerësimin e treguesve global të zhvillimit të konkurrencës në shërbimin shëndetësor. Ndërkohë, çështja e dytë lidhej me politikat qeverisëse në sigurimin e shërbimit spitalor e fokusuar në konkurrencën mes shërbimit privat dhe shtetëror në drejtim të cilësorisë së shërbimit.

nale kronike. Në lidhje me çështjen e konkurrencës nëpërmjet sistemeve të referimit dhe ofrimit të shërbimeve u konstatua se Fon-

di i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor financon katër paketa shërbimesh; paketën e shërbimit të dializës, paketën e shërbimit të kardiologjisë, paketat e shërbimit të transplantit të veshkës dhe paketën e shërbimit të implantit koklear. Përfutjesi me i madh i fondeve buxhetore është QSUT dhe Spitali Amerikan. Të dy këta ofrues ofrojnë të njëjtat shërbime, por referuar numrit të rasteve të trajtuara vitet tre qartë që Spitali Amerikan është i orientuar drejt shërbimit të dializës, kurse QSUT drejt shërbimeve të kontrollit të zemrës. Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 30 shtator 2018.

**Shqipëria, një ndër 5 vendet kryesore që vizitohet me pak lekë**

Një tjetër media botërore, kësaj here në fushën e financës dhe sektorit bankar, ka listuar Shqipërinë në mesin e vendeve tepër ekonomike për t'u vizituar. "5 vendet kryesore në botë për t'u vizituar me një buxhet të ulët", e titullon revista online "Global Banking ang Business Review" artikullin e botuar disa ditë më parë në faqen e tyre. Kënaqësia e udhëtimit në një vend të ri, era e ajrit të

freshët, aromat e ushqimit të shijshëm të paprovuar më parë, një zhytje direkte në kulturën e një grupi të ri njerëzish, të gjitha këto janë përfitimet e një pushimi diku, sipas artikullit. Por, citojmë ekspertët në financa, nëse efekti anësor i një pushimi po ndërhyr në "portofolin" tuaj, kënaqësia nuk është shumë e

madhe. Shtetet e përmendura në artikull janë përkatësisht: Kamboxhia, Turqia, Shqipëria, Peruja dhe Nepali. Sipas redaktorëve, kriteri i marrë në konsideratë është një buxhet nën 70dollarë për person për akomodim, ushqim dhe pije, për 24 orë. Global Banking & Finance Review është një portal kryesor

financiar dhe gjithashtu revistë print, në vitin e 10 të publikimit të saj, që ofron Lajme, Analiza, Opinion, Shqyrtime, Intervista dhe Video nga Bota e Financave, Biznesi, Tregtia, Teknologjia, Investimi, Brokerimi, Shkëmbimi i Jashtëm, Tatimore dhe Ligjore Menaxhimi i Pasurisë, në të gjithë botën.



## KUJTIM

Nikita Hrushovi kishte tre muaj që ishte larguar nga Tirana, kur Tahmaz Beqari që në ditët e para të mbërritjes në Beograd takoi rezidentin e agjencurës

# Beogradi në vitet 1964-1967, çfarë bënte legata shqiptare

Nga Ylli Polovina

**K**ur Nikita Hrushovi do të bënte vizitën e tij në Shqipëri (25 maj - 4 qershor 1959), të cilat qenë jo pak, por dhjetë ditë qëndrimi, madje aq të shumta dhe të dyshimta sa që mobilizuan amerikanët për ta përgjuar me të gjitha burimet e mundshme, Andrea Shkodrani, personazhi real i rrefimit tonë, kishte një muaj nga përfundimi i një shkolle sekrete sovjetike të KGB-së për vetëm zbuluesit shqiptarë ("Fakulteti Special D" në periferi të Moskës).

Prej pranisë tepër të gjatë të Hrushovit dhe heshtjes së papritur të shtypit të Tiranës deri ato çaste përherë me kritika të ashpër ndaj Titos, studentit të porsa-diplomuar dhe në pritje të një emërimi në një komandë shumëkombëshe të Traktatit të Varshavës në periferi të Berlinit në Gjermaninë Lindore, i ra në sy që numrin një të BRSS e shoqëronte rezidenti i ambasadës sovjetike në Beograd. Rezidentin quhet shefi i grupit të agjencurës së fshehtë të një vendi në territorin e një shteti tjetër, gjithnjë të kamufluar si diplomat.

Rezidenti kishte marrëdhënie shumë të mira me ministrin e Brendshëm shqiptar Kadri Hazbiu dhe kur ky i dha në fundgusht 1959 porositi të tij shefit të porsaemëruar të Legatës Shqiptare në Beograd, Tahmaz Beqari, posaçërisht i theksoi se duhej t'i dërgonte kryezbuluesit sovjetik të falat e tij më të ngrohta.

Nikita Hrushovi kishte tre muaj që ishte larguar nga Tirana, prej të cilës pati kërkuar zgjerim dhe shumim të bazave ushtarake sovjetike në Shqipëri, kur Tahmaz Beqari që në ditët e para të mbërritjes në Beograd e takoi rezidentin e agjencurës dhe i përcollti të falat e ministrin Hazbiu.

Kur dy mote më pas, në fundgusht 1961, në Legatën tonë në Beograd mbërriti Andrea Shkodrani, tashmë pothuaj figura dy e saj, rezidenti edhe ky e takoi, për ta përshëndetur edhe ai, për protokol. Por miqësia shtetërore e Shqipërisë me BRSS i kishte ditët të numëruara dhe pasi mori pjesë në një nga mbërrimet e përmuajshme të zbuluesit të Ambasadës Sovjetike, ai do të vihej përballë, bashkë me shefin



Andrea Shkodrani sot

e vet Beqari, një kufizimi të madh. Vendet e kampit socialist ua kishin kthyer shpinën dhe Legata Shqiptare që në cektinë.

Por edhe nga Tirana direktiva që e prerë: të mos takoheshin me asnjë nga këto përfaqësi "revizioniste", sidomos me sovjetikët. Vetëm vonë, në 1964, kur Tahmaz Beqari do të rikthehej në Shqipëri dhe vendin e tij në krye të misionit diplomatik do ta zinte Andrea Shkodrani, ky i fundit siguroi një leje të posaçme nga Ministri i Punëve të Jashtme Behar Shtylla që të mund t'i takonte dhe të bënte edhe bisada me diplomatë të Kampit Socialist.

Ndërkaq në kërkim të burimeve të informimit i pari për të u bë europërëndimor. Ishte austriak dhe në ambasadën e vendit të tij në Beograd mbulonte kulturën. Qe i ri në moshë, lindur dhe rritur në Grac, por të dy prindërit e kishte me origjinë nga Kroacia.

Ishte shumë i shkathët dhe ditte me shumë se çdo tjetër koleg i përfaqësuesit të tij. Pothuaj të gjithë diplomatët e ambasadave të tjera dëshironin ta takonin atë për çdo temë që rrinte ende nën sipërfaqe dhe duhej zbuluar patjetër.

Andrea Shkodrani ishte pikërisht ky austriak që iu afrua, madje nuk e priti hapin e tjetrit drejt tij, siç nuk bënin pak për t'i dëshmuar Shqipërisë se që një vend i vogël dhe shteti i dobët. Dukej qartë që diplo-

mati austriak i donte njerëzit e "vendit të shqiponjave" dhe po ashtu nuk kishte opinion të mirë për serbët, ndërkaq që gjuhën e tyre e fliste shkëlqyeshëm.

Atasheu kulturor austriak të habiste: nuk mbante asnjë rezervë ndaj përfaqësuesit të Legatës Shqiptare.

Diplomati i dytë shumë mik vinte prej një vendi të Kampit Socialist. Ishte hungarez. Me moshë i jhezëte e pesë vjeç dhe që nuk i donte sovjetikët, madje sillavët në përgjithësi, hungarezi ishte i pari dhe më i hershmi me të cilin hyri në kontakt miqësor Andrea Shkodrani i porsaemëruar në Beograd. U njoh me të në festën e 7 nëntorit 1961, përvjetorit të Revolucionit Bolshëvik të Tetorit, ndërsa ambasada sovjetike jepte një pritje të madhe. Pasi shkëmbyen përshëndetjet e para dhe i dha dorën, diplomati hungarez tha shpejt e shpejt fjalët "E dini shumë mirë përse nuk mund të rri me ju" dhe u largua drejt kolegëve të tjerë. Duke qenë se ky lloj qëndrimi Shkodranit i bëri përshlyetje, pyeti për të një diplomat kinez, të cilin ato momente e kishte pranë. Ky iu përgjigj: "Është djale dhe diplomat i mirë, të afrohet, por nuk të hapet shumë".

Por Andrea Shkodrani e fiksioi mirë në kujtesë bashkëmoshatarin e tij dhe jo njëherë ai do të që i dobishëm për shqiptarët.

Kulmore në ndihmën e hurgarazit në dhënie e informacionit tepër të rezervuar ishte ajo çfarë kishte mësuar për vizitën në Jugosllavi (maj 1964) të ministrit sovjetik të Mbrojtjes, Mareshallit Rodion Jakovjeviç Malinovskij. Malinovskij e pati shoqëruar Nikita Hrushobin gjatë dhjetë ditëve të vizitës së tij në Shqipëri dhe ishte i pranishëm kur Enver Hoxha e dëgjoj tek në Butrint i thoshte shefit të tij politik për të ndërtuar aty një bazë të madhe të Traktatit të Varshavës.

## SOVJETIKËT KËRKOJNË BAZË USHTARAKE AFËR SHQIPËRISË

Rodion Jakovjeviç i përfundoi vizitën e tij në Jugosllavi por në majat e rreshtave të gazetave nuk u fol se cila qe arsyeja e kësaj pranie e ministrit sovjetik të Mbrojtjes. Lajmet kishin entuziazëm të shprehur fort, sepse delegacioni kishte qenë i një niveli të lartë, por diplomatët e huaj gërmonin të zbulonin çfarë fshihej pas saj. Sigurisht mes tyre, madje ca më shumë se ata, për shkak arsyesh strategjike, u vu në lëvizje edhe Andrea Shkodrani. Veç qe e vështirë të depërtonte perden mbuluese. Pikërisht kur e humbi shpresën i ra në zyrë me këmbëngulje telefonit.

Ishte diplomati hungarez: "Eja të pimë një kafe!"

Kur u takuan dhe u gjetën vetëm me njëri-tjetrin, ky i fundit e pyeti të Ngarkuarin me Punë të Legatës Shqiptare: "Di ndonjë gjë rreth kësaj vizite?"

Kur Shkodrani iu përgjigj se kishte mësuar vetëm për aq sa pati shkruar shtypi vendas, diplomati hungarez filloi ta informojë për sa kish siguruar informacion dhe për të cilin i kishte kërkuar të takoheshin. Malinovskij u pati kërkuar autoriteteve të larta të Beogradit që t'u siguronin sovjetikëve një bazë të madhe detare në territorin jugosllav. Me sa dukej po përpigëshin të kompensonin mungesën e saj prej prishjes që u kishin bërë shqiptarët asaj të cilën patën në Vlorë.

Vendi i bazës i dëshiruar për sovjetikët qe Kotori.

Njerëzit e Titos nuk kundërshtuan gjatë dhe ranë në parim dakord, por vunë menjëherë në kusht: rusët tua dorëzonin jugosllavëve aparaturnë speciale me anë të së cilës kontrolloheshin tërë ujërat e Mesdheut, sidomos lëvizja e nënde-



tëseve në to. Por kjo pajisje ishte tepër sekrete dhe Moskë nuk mund t'ia dorëzonte askujt të huaji. Kur e kishin pasur në Shqipëri, të vendosur në Porto Palermo, sovjetikët e cmontuan atë në mënyrë të rrefshme e transportuan në BRSS. Nuk e lanë të binte në duart e besnikëve të Enver Hoxhës.

(Për këtë episod jo vetëm politika e kohës së djeshme dhe të sotme, por as historiografia e dekadave të pas gjashtëdhjetës nuk ka shkruar ndonjë rresht. Ajo është përgendruar në betejën që u bë në bazën ushtarake të Pasha Limanit.

Ushtarakët sovjetikë me në krye mareshallin Rodion Jakovjeviç Malinovskin nuk qenë dakort tua dorëzonin superpajisjen përgjese jugosllavëve dhe marrëveshja mes dy palëve, ia shpjegoi Andrea Shkodranit diplomat hungarez antisovjetik, përfundoi me mundësinë që në disa porte të sllavëve të jugut të mund të bazonin për pak ditë anije luftarake ruse dhe me këtë rast marinarët e tyre të mund të pushonin.

Ndërkaq Shkodrani krijoi raporte bashkëpunimi me një diplomat bullgare, ndërsa prej kësaj ambasade vinte atmosfera e kundërt: ndaj Shqipërisë shfaqej egërsi. Madje kjo frymë shprehej që nga kreu i saj dhe deri tek atashu e kulturës. Sjellja ndryshe e diplomates mbase vinte prej një rrethane ndryshe: bashkështori qe me punë në Zvicër dhe i komunikonte të shoqes një mendësi më të hapur. Bullgarja e dha shenjë e afrimit me të Ngarkuarin me Punë të Shqipërisë në Beograd një ditë, në një pritje që po jepte ambasada e Kinës.

Ajo sapo u gjend vetëm me Andrea Shkodranin shpërtheu "në zemërim" dhe e pyeti ngultas se si e kishin shqiptarët gjendjen në Byronë e tyre Politike. Ky ia ktheu: "Pse më pyet? Di ndonjë gjë të jashtëzakonshme?" "Jo, u përgjigj tjetra, por di se çfarë po ndodh në Byronë tonë. Pastaj nisi t'i shpjegojë me hollësi se në Sofje në krye të partisë së tyre patën nisur grindjet e forta mes kryetarit, Teodor Zhivkovit, dhe sekretarit organizativ. Çdo ditë e më shumë ky rreth përplasin shtoi. Nuk qe vetëm një luftë për pushtet personal, por edhe lojë për të gjetur secila palë sa më shumë përkrahje tek Bashkimi Sov- →



Ambasada Shqiptare Beograd



Andrea Shkodrani dhe bashkëshortja e tij Vanthi

DY TEKNIKËT FRANCEZË NË HOTEL "BOZHUR" TË PRISHTINËS

Andrea Shkodrani shkante njëherë në muaj në Kosovë, përherë duke marrë leje në degën e Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë. Në rast se nuk shkante vetëm për këtë punë, e kalonte territorin kosovar, duke e vëzhguar, ndërsa shkante për në Shqipëri ose në rrugën e kthimit prej saj.

Njëherë, ku pati shkuar vetëm për të ndjekur nga afër zhvillimet në Kosovë dhe pati zënë një dhomë në hotelin "Bozhur" të Prishtinës, ndërsa po pinte kafë në holl dhe ndërkaq të gjitha tryezat e tjera qenë të zëna, kërkuan leje të ulyeshin dy francezë. Gjatë bisedës me ta Andrea u ofroi të pinin një gotë konjak shqiptar. Ky konjak me emrin e Skënderbeut mburrej atë kohë se ishte mjaft i pëlqyer nga të huajt dhe për këtë arsye të gjitha përfaqësitë tona diplomatike jash-të pajiseshin me arka të tëra me këtë pije. Kur dy francezët thanë se do ta provonin konjakun e mirë shqiptar dhe Andrea dërgoi tek makina shoferin për të marrë një shishe, shija e saj në dy gotat e porsambushura dy të huajve la një përshytyje befasuese.

Pasi kthyen lehtas nga një gjysmë glënkë dhe Andrea, që priste ta mburrnin konjakun "diplomatik", i pyeti se si i ishte dukur, ata me një gojë u përgjigën "verë e mirë". "Si, more verë, ai është konjak!" shpotti i Ngarkuari me Punë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Jugosllavi, duke e kupur dhe tërthorazi pranuar ironinë e dy francezëve.

Pra, konjaku i mburrur shumë "Skënderbeu" nuk ishte në standardet e propaganduar në Tiranë. Këtë Andrea Shkodrani e vuuri vëth në vesh.

Megjithatë nga biseda atë ditë me dy francezët nuk doli i humbur. Mori vesh se ata qenë teknikë të radiokomunikacionit dhe patën ardhur nga Parisi në Prishtinë sepse mes qeverisë së tyre dhe asaj në Beograd që firmosur një marrëveshje për fuqizimin e radiotransmitimit në shqip të radios së Prishtinës, në një nivel të tillë që të mund të depëronte në çdo skaj të territorit shqiptar.

Njoftoi menjëherë Tiranën. RIKTHIMI NË TIRANË

Ndërkaq pas shtatë viteve punë në kryeqytetin jugosllav, në korrik 1967 Andrea Shkodrani do të rikthehej në atdheun e vet. Një javë më parë pati mbërritur nga Tirana Lik Seiti, me të cilin niveli i marrëdhënieve Shqipëri-Jugosllavi do të ngrihej në nivel ambasadë. Po ashtu edhe do të shtohet personeli i punës, pothuaj në trefishim, përfshi edhe grupin e zbuluesve të kamuflluar si diplomatë.

Periudha e vështirë kur në krye të Legatës kishte qenë Tahmaz Beqari dhe pas tij ai, pati përfunduar.

Kishte shërbyer me një rrogë mujore prej 83 dollarësh dhe bashkë me të shoqen, Evanthinë, me plaçkat e shtëpisë, nga që përditë pritej t'i dëbonin me ndonjë pretekst, gati për t'u hedhur në kaminon. Në Tiranë Andrea Shkodrani sollti me vete një kostum të blerë në Beograd, si edhe një pallto. Po ashtu bashkë me një radio edhe një televizor. Me këtë të fundit thjesht pati pasur fat: një firmë gjermano-perëndimore u dërgoi, me çmime mjaft të ulura, aparate të filla gjithë trupës diplomatike në Beograd.

shtetërore dhe parlamentare të Serbisë. Po ashtu edhe të vendlindjes së vet, deri edhe kryetar i Këshillit Krahinor të Kosovës.

Shoferi kishte marrë pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, kryesisht si koordinator mes PKS-së dhe degës së PKJ për Kosovën. Tani, në prag të pensionimit, kërkonte një vërtetim për vitet e angazhuara në këtë luftë. Sipas një ligji jugosllav ato i njiheshin si vite pune.

Nga biseda me të Andrea Shkodrani mësoi se shefi i tij Mehmet Hoxha nuk kishte qenë dakord asnjëherë me pikëpamjen e Panajot Plakut, sipas të cilit Partinë Komuniste Shqiptare e kishte krijuar ajo Jugosllave. Tani ai që penduar dhe deklaronte se PKS-së ishte vetëkrijuar. Për këtë arsye, këmbënguli shoferi i Mehmet Hoxhës, serbët e kanë izoluar në hotelin "Ballkan" në Beograd dhe i kanë vënë, në rolin e bashkëshortes por edhe të përgjueses, një grua vendase.

Shoferi shtoi se edhe Fadil Hoxha, më i dëguari shqiptar si mik i Titos dhe udhëheqës i Kosovës, për shkak të pikëpamjeve të mëparshme të Plaku nuk kishte shkuar mirë me të, por pas pendimit të tij po i jepte shenja afirmimi.

Kur Panajot Plaku në mes korrikut 1966 vdiq papritur (ishte

kryeredaktori e njëkohësisht përkthyesi, gazetar i "Rilindjes", për një emision radiofonik që transmetohej në shqip dhe serbokroatisht në radion e Prishtinës.

Tekstet i përpilonte përgjithësisht Panajoti, kurse ndihmësi i tij, Tahiri, i cili që nga Elbasani, thjesht i bënte të pranueshme për t'u përcjellë publikut dëgjues, shqiptarëve të Kosovës.

Në të vërtetë ky emision nuk zgjati më shumë se një vit e gjysmë dhe nuk pati asnjë sukses. Në dësh-timin e tij peshoi edhe një frymë e përbashkët e Beogradit dhe e Tiranës për t'i zbutur tensionet mes tyre dhe përmirësuar marrëdhëniet. Me pak fjalë Josip Broz Tito nuk kishte më nevojë t'i rrinin nëpër këmbë njerëz të acarimit, prandaj edhe porositi që Panajot Plaku të lihej mënjani.

Ishte ky cast kur në Legatën Shqiptare në Beograd u shfaq shoferi i Mehmet Hoxhës, politikan, i cili në Kosovë pati qenë udhëheqës i luftës së rezistencës kundër pushtimit gjerman dhe pas vitit 1945 vendosur në poste të rëndësishme

jetik. Ky kishte baza të rëndësishme ushtarake në Bullgari, prej ku një agresion ndaj Shqipërisë kryhej në afate kohorë shumë më të shpejtë nga çdo pozicion tjetër përreth.

I Ngarkuari me Punë nuk e largoi kurrë nga vëmendja diplomatit bullgar dhe herë pas here gjuan-te "zemërimin" e saj.

Andrea Shkodrani iu afrua edhe ambasadores së Republikës së Gjermanisë Lindore, e cila ishte bijë e udhëheqësit të njohur pro-letar Vilhelm Pik. Quhej Anna. Ajo kishte shumë simpati për Shqipërinë dhe rasti e pati sjellë që në takime me intelektualë të vendit tonë, përfshi edhe të Ngarkuarin me Punë të Tiranës në Beograd, të konstatonte se ata dinin gjermanisht.


Por Anna Pik që shumë e kycur në dhënie e informacionit, zakon që si rregull e kishin të gjithë diplomatet e ambasadës gjermano-lindore.

PANAJOT PLAKU NUK GJEN REHAT

Andrea Shkodranit kur në gusht 1961 Kadri Hazbiu e thirrri për t'i komunikuar direktivat e tij për punën e zbuluesit të kamuflluar në Beograd si diplomat, nuk i zuri në gojë Panajot Plakun. Ky, anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së dhe po ashtu gjeneral, ishte arratisur nga Shqipëria në vitin 1957 dhe ato çaste që ende mjaft agresiv kundër regjimit të Tiranës dhe Enver Hoxhës. Sipas rregullit më të thjeshtë për ata që paraqiteshin më agresivë dhe përbënëin rrezikshmëri, Hazbiu duhej, mes detyrave që i dha, të përcaktonte edhe ndjekjen e veprimeve të Plakut. Mirëpo ministri nuk bëzajti dhe heshtja e tij i bëri përshytyje Andrea Shkodranit, por e justifikoi këtë çështje topsekreti. Gjykoj se Kadri Hazbiu pati ngarkuar me këtë mision ndonjë person tjetër apo disa të tillë dhe me këta merrte kontakt vetë, të drejtëpërdrejtë.

Ose kjo ishte shndërruar në monopol të kryeministrit Mehmet Shehu e në mos të Enver Hoxhës personalisht.

Ndërkaq kur shkoi në Beograd mësoi se Panajot Plaku që vendosur në kushte ruajtjeje të fortë në një vilë në Dalmaci dhe se prej andej organizonte botime propagandistike me artikuj kundër Tiranës dhe regjimit hoxhist. Pastaj e sollën në Beograd dhe këtu i caktuan një lloj



Tahmaz Beqari

Opinion i Ditës

# Krim dhe ndëshkim: Lidhja e shqiptarëve me krimin dhe kostoja që shkaktohet në ekonomi

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

... të krimin janë shumë duke variuar nga dobësia e institucioneve shtetërore, varfëria dhe mungesa e mundësive ekonomike për të rinjtë, kultura e pandëshkueshmërisë nga ligji e deri te mentaliteti që e favorizon apo e toleron krimin. Mirëpo duhet pranuar se kultura jonë sot është një ndër shkaktarët kryesor, sepse jo vetëm që nuk e dënon krimin, por e toleron dhe në njëfarë mënyre e inkurajon. Kjo pasi këtë përfshirje masive në krim shqiptarët e kanë jo vetëm në vendlindje, por edhe në emigracion, ku shteti ligjor e kushtet sociale nuk lënë hapësirë për t'u auhar.

Miti kryesor, që e justifikon këtë indiferencë apo bashkëjetesë me krimin mes shqiptarëve, është iluzioni se paratë e krimin, pavarësisht se janë të pista, e ndihmojnë ekonominë. Për këtë arsye, këta kriminelë apo "djem të shkathët", siç është shpesh eufemizmi për ta, shikohen si shpëtimtarë të ekonomisë shqiptare apo rrugëdalje nga varfëria. E vërteta është krejt ndryshe! Këto para të pista, jo vetëm që nuk e ndihmojnë ekonominë dhe të ardhmen tonë, por e pengojnë dhe e gërrasin atë. Vendosa ta shkruaj këtë shkrim, pikërisht se jam lodhur së degjuari të njëjtin avaz të përsëritur nga njerëz të ndryshëm, kështu që herës tjetër që më hapet e njëjta temë thjesht do iu dërgoj këtë artikull.

## BASHKËJETESA ME KRIMIN

Ne të folurëve e përditshme në Shqipëri ose Kosovë, dominon një magjepsje ndaj personazheve të krimin dhe një pjesë e mirë e shoqërisë, përfshi këtu njerëz të famshëm e politikanë, mezi presin që të rrinë në pranë të këtyre "të fortëve". Tavolinat e kafeneve shqiptare janë të tejmbushura me biseda që bëhen tërë zili e admirim për bëmat e kriminelëve shqiptarë, duke nxjerrë në pah burrrërinë, krenarinë, forcën apo dinakërinë. Janë të shumtë ata që krekosen e lëvdojnë dikë thënë se këtu prostitucionin e kontrollojnë shqiptarët, aty e bëjnë ligjin shqiptarët, aty dominojnë trafikun e drogës bashkëpatriotët tanë etj. Për mos të folur pastaj për justifikimin më banal që përdoret i tipit "dikush duhet ta bëjë atë punë kështu që më mirë ata se dikush tjetër". Shprehja mandej që të bën për të vjellë e të nxjerr zorrët në grykë për nga përmasat e injorancës dhe naivitetit është se "krim ka kudo, edhe Amerika u zhvillua prej krimin, ja shiko Al Capone".

Një ndër legjendat urbane që



qarkullon më shumë e që thuhet gjithë krenari, është që, mafia e Italisë është nisur nga arbëreshët. Kjo gjë është tërësisht e pavërtetë, madje arbëreshët tanë si ata të Horës së Arbëreshëve në Sicili, duke qenë nën autoritetin e papës, por të traditës ortodokse historikisht as që japin e marrin me fshatra fqinj katolike si Korleone që konsiderohet epiqendër e Mafias. Në fakt, rasti, i jugut të Italisë, të infektuar nga mafia, është dëshmia më e qartë se krimi masiv, kurrsesi nuk sjell begati e zhvillim. Përkundrazi, sjell mjerim, prapambetje e emigracion.

Bashkëjetesën e rehatshme me krimin e dëshmon edhe mentaliteti ynë që nuk dënon banditët, por nënmon ata që denoncojnë, dëshmojnë apo raportojnë krimin duke i konsideruar "spiunë". Janë të paktë ata që e konsiderojnë denoncimin e krimin si një akt të përgjegjësive së qytetarit që meriton të lavdërohet. Ata që vjedhin, trafikojnë apo korruptohen konsiderohen si të shkathët, të zgjuar, të zotë, ndërsa ata që nuk përfillojnë apo mundësitë konsiderohen leshko, apo budallenj ose thjesht frikakakë.

Po ashtu këtë bashkëjetesë apo indiferencë ndaj krimin e tregon edhe lehtësia me të cilën blihen apo përdoren sendet e vjedhura mes shqiptarëve. Është me të vërtetë për të qarë hallin kur shihet se ka boll njerëz të pasur që edhe pse ua lejon xhepi, do të preferonin të blijnë diçka të vjedhur e të lirë përpara diçkaje të blerë ligjshëm. Këtë dimension e ilustron më së miri

rasti tragjikomik i ish-ministrit socialist të rendit, Spartak Poçi, i cili u kthye në kufi nga Greqia, sepse udhëtonte me një makinë të vjedhur në perëndim.

Nëse shoqëria jonë do ta dënonte krimin e jo ta glorifikonte atë, me siguri niveli i krimin tek ne do të ishte shumë më i ulët se sa e kemi sot. Pothuaj të gjithë keqbërësit shqiptarë kanë prindër, vëllezër, motra, kushërinj apo miq, të cilët, jo vetëm që nuk kanë mbajtur qëndrim moral qortues, por e kanë toleruar e madje inkurajuar veprimtarinë e tyre të paligjshme. Familjarët i kanë fërkuar duart kur djemtë refugjatë sillnin para apo sende të grabitura me bollëk nga emigracioni. Ata në njëfarë mënyre janë justifikuar me argumentin se "shqiptarët bëjnë çfarë bëjnë andej, por në Shqipëri janë djem të mirë" ose thënë popullore "çunat tanë nuk përmjerin atje ku hanë e ku jetojnë". Mirëpo shumë shpejt tymen që bënin jashtë shtëpisë "djemtë e shkathët" e sollën dhe në shtëpi, gjë që u pa më së miri në vitin 1997, por edhe po shihet dita-ditës me përplasjet me bandave.

Së pari, njëherë duhet pasur kurajë e singëritet e duhet thënë që niveli i kriminalizimit mes shqiptarëve, sidomos atyre të shtetit amë, është i përmasave të jashtëzakonshme. Një ndër mënyrat për ta dëshmuar këtë fakt të hidhur është numri i të burgosurve. Kështu duhet vënë në dukje se brenda Bashkimit Evropian, shtetasit e Republikës së Shqipërisë ndodhen në krye të renditjes së të burgosurve që vijnë nga vendet jashtëkomuni-

Faktikisht krimi i zhvilluar në Shqipëri rrënon pikërisht këto dy shtylla të zhvillimit ekonomik. Jo vetëm që ka sjellë një tumor malinj në sistemin e drejtësisë dhe rendit, por tanimë ka lëshuar metastaza vdekjeprurëse edhe në sistemin e demokracisë. Më përpara në Shqipëri kriminelët u paguanin rryshfete politikanëve për të siguruar ndonjë favor apo imunitet. Politikantë i rekrutuan ata e i përdorën si instrumente elektorale. Mirëpo në vijim "djemtë e shkathët" i anashkaluan politikanët dhe ua zunë vendin në parlament duke u bërë vetë politikanë e duke e kalbur në nivel kapilar sistemin tonë të demokracisë.

Po ashtu, krimi dëmtion edhe një shtyllë tjetër të zhvillimit ekonomik, që është konkurrenca. Ekziston një lidhje e fortë shkak pasojë mes nivelit të konkurrencës në ekonomi dhe rritjes së ekonomisë pasi konkurrenca vendos presion mbi firmat për të rritur efikasitetin e tyre, nxjerr nga tregu firmat që janë më pak produktive si dhe detyron firmat që të jenë novatore duke sjellë produkte e shërbime të reja. Konkurrenca e lirë dhe e ndershme rrit edhe mirëqenien e cilësinë e jetës së individit pasi i detyron sipërmarrësit që të rrisin cilësinë e shërbimeve apo mallrave apo ulin çmimin e tyre për të mbajtur konsumatorin të kënaqur Kur kanë të bëjnë me konkurrencën, biznesmenët që i kanë bërë paratë nëpërmjet krimin, e kanë forcën e zakonit prej përvojës kriminale që të përdorin dhunën, kanosjen, presionin ose mashtrimin. Po ashtu kanë tendencën dhe praktikën që të shkelin ligjin dhe që të godasin konkurruesit duke paguar rryshfete në administratë për të shmangur rregulla, standarde apo kushte specifike. Për më tepër duke korruptuar zyrtarë që i tolerojnë evazionin fiskal apo kontrabandën si dhe nëpërmjet presionit apo rryshfeteve këta janë të parët që sigurojnë tenderët publikë në mënyrë të pamerituar. Të gjitha këto elemente i japin këtyre biznesmenëve një avantazh të krahësuar përkundërjt biznesmenëve të ndershëm dhe i privojnë qytetarët nga përfitimet që vijnë natyrshëm prej konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Një ndër dëmet më të mëdha që bëjnë paratë e pista të hedhura në investime është efekti dumping me të cilin shkatërrojnë konkurrencën e ndershme. Shumë individë që kanë para të shumta që burojnë nga aktivitetet të paligjshme, bëjnë investime në sektorë të ndryshëm të tregut të kamufillojnë aktivitetet e tyre të dyshimta ose që të pasurojnë paratë e pista, pa e vrarë mendjen për fitimin nga këto biznese. Ata shpesh janë të gatshtëm që t'i operojnë këto biznese edhe me humbje apo duke ofruar shërbime apo produkte nën kosto, gjë që e bën të pam-

Miti kryesor, që e justifikon këtë indiferencë apo bashkëjetesë me krimin mes shqiptarëve, është iluzioni se paratë e krimin, pavarësisht se janë të pista, e ndihmojnë ekonominë. Për këtë arsye, këta kriminelë apo "djem të shkathët", siç është shpesh eufemizmi për ta, shikohen si shpëtimtarë të ekonomisë shqiptare apo rrugëdalje nga varfëria.



← undur që të konkurrohen nga biznese të ndershme që jetojnë me të ardhurat jo vijnë prej fitimit të biznesit e jo burime të dyta. Për rrjedhojë kjo konkurrencë e pandershme shkakton dumping e nxjerr nga loja aktorët e ndershëm ekonomik në vend duke e kalbëzuar akoma më shumë ekonominë në vend.

Një tjetër dëm i madh është inflacioni. Qytetarët kane iluzionin se paratë e shumta të ardhura nga krimi ndihmojnë ekonominë duke qarkulluar, mirëpo nuk e kuptojnë se si pasojë e tyre jeta shtrëngohet në mënyrë të paarsyeshme duke ua rënduar xhepi. Këta që i bëjnë paratë në sasi të mëdha pa dërsitur shumë edhe i harxhojnë paratë në mënyrë moskokëçarëse duke shkakuar inflacion. Rasti më klasik ilustrativ është inflacionimi që iu bëhet banesave në Tiranë duke rritur çmimet në atë nivel, sa për një çift të ri që bën punë të ndershme e bën të papërbalueshme çmimin e një banese.

Një tjetër dëm që na shkaktohet është edhe njolllosja e imazhit tonë ndërkombëtar. Ekonomistë të shumtë mendojnë se imazhi ndërkombëtar sot ka ndikim të drejtpërdrejtë tek zhvillimi ekonomik pasi në varësi të tij tërhiqen ose largohen turistët dhe investitorët. Po ashtu ndikon në suksesin që ka eksportimi i shërbimeve apo prodhimeve të një vendin. Pësha politike e vendit tonë në arenën ndërkombëtare, mundësia jonë për të bërë marrëveshje ndërkombëtare ekonomike të favorshme, përpjekja për të gjetur tregje të reja apo burime të reja të lëndës së parë, varen drejtpërdrejtë nga imazhi i vendit. Për mos të folur pastaj për trajtimin e shtetasve shqiptarë kur udhëtojnë. Sa herë që udhëtojmë jashtë shtetit e ndihemi të diskriminuar, të përçmuar apo ballafaqohemi me mungesë mirësjellje, dyshim apo paragjykim duhet të mendojmë se ajo gjë nuk është krejt rastësore, por ka arsye objektive përse na ndodh. Fajin duhet ta gjejmë nëpërmjet pasqyrës, tek "djemtë e shkathët" që na rrethojnë e të lehtësia me të cilën bashkëjetojmë me ta.

Në këtë aspekt bie në sy një tjetër perceptim i gabuar me shqiptarin tipik që konsideron biznesmen këdo që është i pasur dhe nuk e bën dot dallimin mes pasanikut (atij që ka para) dhe sipërmarrësit (atij që bën para). Në epokën moderne të financës jo jetojmë sot me shumë rëndësi ka shpirti i iniciativës e aftësia menaxheriale, sepse paratë i ka banka, e cila është e gatshme që t'i japi kredi kujtdo që ka ditur të hartojë një projekt që ka shans të larta sukseseshme. Nuk është rastësi që në Shqipëri sot është ndërtaur një kastë e tëra biznesmenësh pa aftësi të menaxhimit të biznesit, që i kanë gjasat larta që të falimentojnë në momentin e parë që iu ndalen paratë e pista apo favorizimet nga qeveria.

Kuptohet që për t'u bërë kriminel i suksesshëm e i pasur nuk kërkojnë arsim apo përvojë profesionale, por thjesht kërkojnë guxim, forcë, mungesë skrupujsh, dinakëri e mi-zori, veçori këto që nuk pinë ujë në menaxhimin e biznesit. Prandaj kur paratë janë masivisht të përqendruara në duart e kriminelëve, kuptohet që për shkak të përgatitjes së tyre mediokre edhe investimet e tyre do të jetë në sektorë mediokër të ekonomisë dhe rezultati do jetë i keq për mbarë ekonominë. Ata nuk din ta bëjnë një biznes, po që se nuk kanë prurjen e vazhdueshme të parave të pista gjasat janë që të falimentojnë menjëherë. Prirja e tyre

është që të investojnë në biznese të thjeshta, që nuk kërkojnë aftësi të mëdha menaxheriale, duke imituar shpesh njëri tjetrin. Të tilla biznese janë kafenetë, restorantet, hotelet, ndërtimet , pikat e karburantit, bastoret etj. Pra, kjo prirje bën që një pjesë e mirë e kapitalit të ekonomisë të përqendrohet në dy tre lloj biznesesh ndërkohë që neglizhohen sektorë të tjerë që kanë potencial më të madh zhvillimi. Kjo nga njëra anë shkakton një kosto të madhe oportune për ekonominë (sikurse është varrosja e miliarda eurove në ndërtime të dhjetëra mijëra apartamenteve në bregdet) e nga ana tjetër shkakton fluska të rrezikshme ekonomike sikurse



është ajo e ndërtime, të cilat rrezikojnë të infektijnë të gjithë ekonominë.

Një nga sektorët më të preferuar nga banditët shqiptarë për të hedhur paratë e pista është bar-restoranti. Ky lloj biznesi i thjeshtë e bën shumë të lehtë pastrimin e parave dhe nuk kërkon shumë tru për t'u administruar. Sipas të dhënave më të fundit të Anketës Strukturore të INSTAT-2016, në Shqipëri numri i bar-kafave e restoranteve arriti në 18,795 (14,200 bare dhe 3,965 bar restorante), me një rritje prej 6.3% në raport me vitin e mëparshëm. Në raport me popullsinë prej 2.87 milionë banorësh, në Shqipëri ka 654 bar-kafe për 100 mijë banorë çka na bën të parët në botë për numrin e lartë të bar-kafave për banorë, duke lënë prapa Spanjën që ka një bar-kafe për 169 banorë.

Kur flitet për koston e kriminit, Organizata Botërore e Shëndetësisë bën një dallim mes kostove direkte dhe kostove indirekte të kriminit. Me kosto direkte përkrahëhet vlera e të mirave apo shërbimeve të përdorura për të parandaluar krimin ose për të trajtuar viktimën apo shkaktarët e kriminit. Kur flitet për individë apo biznese llogaritet impakti i drejtpërdrejtë që vjen prej humbjes së produktivitetit për shkak të lëndimit, plagosjes apo vdekjes, pagesat që paguhen si haraç, kostot e riparimit apo zëvendësimit të pronës së dëmtuar, kostot e shërbimeve shëndetësore, kostot për shërbimet juridike, kostot e sigurimeve etj. Mirëpo individët dhe bizneset paguajnë edhe

në mënyrë indirekte duke shpenzuar në masa parandaluese duke paguar për sisteme alarmi apo polici private, duke paguar haraç, duke pësuar trauma psikologjike nëse janë viktimë të kriminit etj. Qeveritë, gjithashtu, kanë kosto të mëdha, sepse krimi shton shërbimet shëndetësore, shpenzimet policinë dhe drejtësinë, për sistemin e burjeve etj. Kështu qeveria në vend që të investojë në arsim apo infrastrukturë që ndihmojnë rritjen ekonomike, detyrohen të harxhojnë më shumë para në sektorë jo-produktiv si siguria, policia, shërbimet shëndetësore etj.

Për të krijuar një ide më të qartë të koston së burjeve, duhet për-

hen prej tyre si të rrezikshme. Si pasojë e rrezikut shumë qytetarë detyrohen të largohen dhe kjo zhvendosje ka një kosto të sajën të madhe jo vetëm financiare por edhe emocionale Viti 1997 në Shqipëri ka qenë pa dyshim viti me nivelin më të lartë të migrimit të brendshëm në vend gjatë tranzicionit.

Shtimi i kriminit sjell edhe masivizimin e të droguarve që dëmton ofertën në tregun e punës. Të qenit prodhues masiv i hashashit dhe korridor i trafikut të drogave të rënda ka bërë, gjithashtu, që rinia të ketë një qasje më të lehtë tek droga duke i siguruar me çmimin më të lirë dhe për rrjedhojë duke i konsumuar më masivisht. Për pasojë kemi një rritje të konsumit vendas të drogës në Shqipëri. Revista "The Economist" në prill të këtij viti raportonte listën e vendeve që konsumojnë më shumë kokainë e kryeson Shqipëria ku 2.5% e popullsisë është përdorues i kësaj droge.

Cilësia e burimeve njerëzore, të rinjtë duke parë kriminelët e pasuruar shpejtë me makina e veshej luksoze, humbasin respektin për arsimin dhe nuk e shohin më shkollën si rrugën që çon drejt prosperitetit. Rinia shqiptare duke u joshur nga makinat e shtrenjta dhe stili ekstravagant i cubave e banditëve e ka të vështirë që të zgjedhë të sigurojë të ardhmen nëpërmjet durimit, këmbënguljes, punës së ndershme e shkollimit. Për ta krimi paraqet një mundësi reale joshëse për t'u bërë shumë i pasur shpejt pa dërsitur anipse me shumë risk.

Prania e lartë e kriminit ka, gjithashtu, një dimension gjinor, sepse sjell një kosto të shtuar për gratë e vajzat, të cilat konsiderohen më të kërcënuara nga shoqëria e për rrjedhojë privohen nga shumë aktivitetë shoqërorë që familjarët e tyre i konsiderojnë të rrezikshme. Pikërisht se mendohen më të ekspozuara ndaj kriminit, vajzat hiqen para kohe nga shkolla, nuk i lejohej të frekuentojnë ambiente të ndryshme, të udhëtojnë apo të punësohen dhe familja shndërrohet për to shpesh në një burr. Prania e lartë e kriminit gërryen besimin dhe respektin tek institucionet e proceset si dhe i dekurajon prej angazhimit në jetën politike e proceset demokratike. Madje mund t'i çojë që të gjejnë zgjidhje alternative për t'u ballafaquar me kërcënimin që sjell krimi duke shkuar drejt vetëgjyqësisë, armatosjes apo edhe braktisjes së vendit.

Lista e dëmeve që i shkaktohen shoqërisë në përgjithësi dhe ekonomisë në veçanti, është shumë më e gjatë dhe e detajuar dhe një artikull nuk ka shans që ta shpjegojë më jafhtëshëm. Mirëpo ka ardhur koha, që përveç përpjekjeve për të forcur institucionet e rendit dhe ligjit, të reflektojmë e ndryshohemi përbrenda vetë si shoqëri. Ne kemi nevojë për një përmbyasje të mirëfilltë në kulturën tonë për sa i përket lidhjes që kemi me krimin si shoqëri dhe për t'u parë kriminelët e shumtë që njohim e që na rrethojnë e shi heronj, por si shkaktarë e faktorë të drejtpërdrejtë të varfërisë, papunësisë, prapambetjes, njolllosjes së atdhut tonë, infrastrukturës së shkatërruar, cilësisë së ulët të shërbimeve publike, institucioneve jofunksionale e shumë problemeve të tjera që hasim çdo ditë. Nëse nuk i ndëshkojmë në moralisht kriminelët, nëse nuk i ndëshkon shteti ata ligjërisht, atëherë ndëshkohet mbarë shoqëria, e bashkë me shoqërinë ndëshkohet secili nga ne.

**Bashkëjetesën e rehatshme me krimin e dëshmon edhe mentaliteti ynë që nuk dënon banditët, por nënçmon ata që denoncijojnë, dëshmojnë apo raportojnë krimin duke i konsideruar "spiunë". Janë të paktë ata që e konsiderojnë denoncimin e kriminit si një akt të përgjegjshëm së qytetarit që meriton të lavdërohet.**

**HOROSKOPI**

---

**DASHI**

Do të kaloni kohë duke kryer aktivitetet sportive për të mbajtur trupin në formë. Duhet të mendoni për të realizuar disa ndryshime në arredimin e shtëpisë. Sot do të kuptoni sesa shumë iu do partner/partnerja juaj.

---

**DEMI**

Duhet të bëni pak pushim për t'u qetësuar psikologjikisht. Përpiguri të mos investoni në disa skema të dyshimta financiare me të cilat do të njiheni gjatë ditës së sotme. Ka gjasa të humbisi diçka, ndaj duhet të tregoheni shumë të vëmendshëm.

---

**BINJAKET**

Sjellja juaj do të vlerësohet maksimalisht. Eshhtë dita e duhur për të komunikuar me persona, të cilët i takoni shumë rrallë. Romanca do të drejtojë zemrën tuaj. Aftësia për të ndihmuar të tjerët do të sjellë respekt ndaj jush.

---

**GAFORJA**

Shmangni konfliktet pasi mund t'ju shkaktojë stres. Keni mundësi për të fituar para nëse do të veproni, ashtu siç duhet. Nëse kenë në plan të udhëtoni, sigurohuni mirë dhe bëni shumë kujdes me dokumentet tuaja.

---

**LUANI**

Do të ndiheni të mërzitur pasi ka gjasa të përballeni me një problem shëndetësor. Ka gjasa t'u krijohen burime të reja të të ardhurave. Mungesa e komunikimit iu bëni person që ju e doni shumë, do t'ju shndërohet në stres.

---

**VIRGJERESHA**

Do të përballeni me shumë gjëra, por ruani qetësinë, pasi do t'ju duhet të ndërmerrni vendime të rëndësishme. Do të kaloni një mbrëmje të mrekullueshme me miqitë. Do ta kenë të vështirë të bëni partner/partneren tuaj të kuptojë pozicionin në të cilin ndodheni.

---

**PESHORJA**

Nisni mëditimin dhe jogën, për t'u ndjerë mirë si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Ka gjasa që debati me një fqinjin/ën tuaj t'ju prishë humorin. Megjithatë ruani qetësinë, përkundrazi vetëm do të përqesoni situatën. Duhet të kaloni më shumë kohë me partner/partneren tuaj.

---

**AKREPI**

Bëni mirë të mendoni pozitivisht. Gjendja financiare do t'ju përmirësohet, por sërish do të ndieni vështirësi në realizimin e planeve tuaja. Mbrëmja me partneren/partnerin tuaj do t'ju relaksojë dhe do t'ju krijojë një gjendje të mirëkullueshme.

---

**SHIGJETARI**

Do të vlerësoni një mikun tuaj për suksesin e arritur. Do të fitoni para sot, por për shkak të rritjes së shpenzimeve do ta kenë të vështirë të kurseni. Mund të merrni një lajm që do t'ju lumturtojë pamasë.

---

**BRICJAPI**

Sot do të përfshihen në punë kreative. Ka gjasa të realizoni një plan shumë të rëndësishëm. Dikush do përpiqet t'ju lëndojë duke punuar kundër jush. Megjithatë aftësia juaj për të vepruar me zgjuarsri do t'ju bëjë ta kaloni këtë situatë.

---

**UJORI**

Sot të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore dhe do të nisni të kryeni ushtrime fizike. Ka gjasa që një udhëtim që kishit planifikuar, t'ju shtyhet. Shmangni personat që përpiqen të prishin reputacionin tuaj.

---

**PESHQIT**

Disa persona mund të mendojnë se jeni shumë të vjetër për të mësuar diçka të re, por kjo nuk është aspak e vërtetë pasi do të jeni në gjendje të mësoni shumë shpejt, për shkak të zgjuarsisë suaj, t'ju falë emocione të pahurueshme.

### Ylli portugez në një intervistë

## Ronaldo: Nuk më intereson kriza e Realit, fitoj në fushë me Juventusin

Kristiano Ronaldo nuk është një futbollist që jep deklarata të gjata për shtyp dhe shpeshherë është edhe diplomat, duke mos krijuar lajme. Por në konferencën e djeshme para ndeshjes kundër Manchester Junajtid, Ronaldo ka folur për të gjitha. Çështjen e përdhunimit, rikthimin në Manchester, kriza e Realit dhe gjithashtu u është përgjigjur "thumbave" të Iskos ndaj tij.

#### A ndiheni viktimë e një komploti? (Çmimi i UEFA-s)

Unë nuk jam i fiksuar me çmime individuale. Duhet të përqendrohem në dy muajt e fundit me Juventusin. Ishin muaj fantastikë, gjithçka shkoj mirë dhe ekipi është fantastik, çmimet nuk do të thonë asgjë.

#### A është Juve është në nivelin e Realit?

Unë nuk dua të bëj krahasime, janë të dyja skuadra shumë të mira. E kam mbyllur me Realin, Juventus

është një kapitull i ri. Jam i lumtur që kam luajtur me skuadra si Manchester, Real Madrid dhe Juventus. Jam i lumtur dhe një njeri me fat.

#### Si e shihni krizën e Realit?

Unë nuk dua të flas për klubet e tjera, të gjithë e njo-

hin historinë time me Realin. Por nuk është koha e duhur. Juve luan një ndeshje vendimtare nesër (sot) dhe nuk kam pse të flas për Real Madridin.

#### Çfarë është Juve për CR7 pas 100 ditësh të para me fanellën bardhezi?

Jam i lumtur që jam këtu

në një ekip të shkëlqyer dhe jam ende duke u përshtatur Serie A. Është ndryshe nga e kaluara, shokët e mi më ndihmojnë shumë dhe jam duke shijuar momentin.

#### A ndiheni një shembull në fushë dhe jashtë fushës?

Unë e di që jam një shembull në fushë dhe jashtë saj.

Gjithmonë jap buzëqeshje, jam i lumtur dhe jam me fat që luaj në një ekip fantastik, kam katër fëmijë, një grua fantastike, pjesa tjetër nuk më mërzi.

#### Nëse nesër (sot) shënon kundër Junajtid, do të festoni?

Ashtu si edhe herën tjetër, domethënë jo.

#### Çfarë mendoni për çështjen e Majorkës?

Ju nuk e kenit dëgjuar atë që kam thënë një deklaratë publike. Nuk kam çfarë të shtoj.



Jeton Selimi

Në Vlorë Flamurtari-Tirana përfundon 1-0. Danilo Alvesh shënon golin e vetëm në minutën e 72-të

# Flamurtari rilind ndaj Tiranës së brishtë

## Mema debuton me humbje në stolin bardheblu

Takimi Flamurtari-Tirana ka ulur siparin e fazës së parë të Kategorisë Superiore. Në sfidën e luajtur në Vlorë kanë triumfuar kuqezinjët e Ilir Dajës falë golit të shënuar nga Danilo Alvesh në minutën e 72-të. Ardian Mema debuton me humbje në stolin e Tiranës, ndërsa bardheblutë regjistrojnë disfatën e 5-të në 9 javë kampionat.

#### NDESHJA

Flamurtari rigjen fitoren dhe këtë e bën falë Danilo Alveshit, goli i të cilit mjaftoi për të mposhtur Tiranën dhe për t'u luajtur kuqezinjtë vlonjatë të ruajnë hapin e Teutës, me dy skuadrat që ndajnë vendin e pestë me nga 14 pikë secila. Ndërkohë debuton me humbje Ardian Mema, trajneri i ri i Tiranës, që zëvendësoi në detyrë Ze Marian dhe që la pikërisht postin e zvtrajnerit të Flamurtarit për t'u bashkuar bardhebluve. Por nuk mundi dot Mema ta nisë me këmbën e mbarë. Tirana duket se vion të ketë ende problemet e trashëguara që me nisjen e sezonit, ndërsa në Vlorë edhe njëherë u pa brishtësia e skuadrës, që nuk mun-



di dot të finalizojë dhe as të mbrojë. Si në rastin e minutës së 72-të, kur Hysenaj lëviz shumë mirë në

qendër dhe Alvesh nuk fal gabimin e disatë të mbrojtjes bardheblu. Kjo, sepse në stadiumin "Fla-

murtari" asnjëra nga skuadrat nuk do ta dominojë tjetrën dhe situatat në portat respektive do të jenë

SUPERLIGA		
JAVA E 9-të		
<b>TE SHITUNEN</b>		
Kastrioti - Kukësi		1-2
Laçi - Teuta		0-3
<b>TE DIELEN</b>		
Skënderbeu - Kamza		2-0
Partizani - Luftëtari		1-2
<b>TE HENEN</b>		
Flamurtari - Tirana		1-0
RENDITJA		
SKUADRA	N	F
Partizani	9	22
Skënderbeu	9	20
Laçi	9	16
Kukësi	9	16
Teuta	9	14
Flamurtari	8	14
Tirana	8	8
Kamza	9	7
Luftëtari	9	6
Kastrioti	9	4

në kuadrat, me përjashtim të momentit të golit, ku gardiani bardheblu ishte i pafaj. Do të mjaftojë ky gol i vetëm për të ndarë pikët në Vlorë, me Flamurtarin që merr maksimumin dhe Tiranën që rikthehet në kryeqytet me humbjen e dytë radhazi, e pesta në këtë sezon, ku në 9 ndeshje kanë mundur të marrin vetëm dy fitore dhe dy barazime, për një total prej 8 pikësh, 14 më pak sesa Partizani kryesues. Tirana aktualisht mbetet në zonën e ftohtë të renditjes, por më keq se kjo është psikologjia e rënduar në ambientin bardheblu, që duket se nuk janë në gjendje jo më të përmeshin objektivat e fillimsezonit, por të reagojnë për t'u larguar Luftëtarit të parafundit, që është vetëm dy pikë poshtë tyre.

zero, me Likën dhe Koliçin, që kalojnë një mbrëmje të qetë, pasi asnjë gjuajtje kërcënuese nuk do të vijë

### TRAJNERI I TIRANËS

## Mema: Objektivat? Ato i ka vendosur ish-trajneri



e realizoi me sukses. Jam i kënaqur me ekipin. Edhe kur luan mirë, edhe kur humbet ekipi të jep garanci për të ardhmen. Ngoo? Unë nuk jam për të ndëshkuar njerëz,

jam për të punuar dhe disiplina në ekip është gjëja më e rëndësishme, sepse pa të nuk bëjmë asnjë gjë. Hasani është zgjedhja ime dhe marr përsipër atë çfarë bëjnë në fushë lojtarët. Objektivi i parë është që Tirana të ngjitet, e rëndësishme është të kapim ndeshjet hap pas hapi. Objektivat duhet t'i shohim në një moment të dytë, ato kanë qenë me ish-trajnerin. Kam dëgjuar që çdo ekip ka synim Kupat e Europës, por ne duhet të jemi me këmbë në tokë dhe t'i marrim ndeshjet hap pas hapi", - u shpreh Mema.

### TRAJNERI I FLAMURTARIT

## Daja: E dinim që do vendosej nga një episod


Trajneri i Flamurtarit, Ilir Daja u shpreh shumë i kënaqur me pikët e marra dhe pranoi se ndeshja do të vendosej nga një episod, ashtu siç ndodhi edhe në sfidën kundër Tiranës. Për "Supersport" pas ndeshjes, Daja tha: "Edhe para ndeshjes e kishim shprehur që do të ishte e luftuar në mesfushë dhe do e vendoste një episod, siç ndodhi. Kemi bërë mirë në fazën e mbrojtjes, por jo shumë mirë, se edhe Tirana ka lojtarë të mirë në përbërje. Na vuri në vështrësi dhe për këtë ka meritë edhe Mema. Duruam, ishim të pë-



gatitur për nerva të forta, pritëm momentin që na buzëqeshi. Marrim tri pikët dhe në këtë fazë të dytë kemi më shumë ndeshje në shtëpi. Njohja është reciproke me Memën, se kemi punuar

bashkë. Kishte plus Mema, se kur ndërrohet trajneri, ekipi ka motivim më të madh. Jo se është kolegu im, por çdokujt i duhet kohë të implementojë idetë e tij. Pashë një Tiranë ndryshe, bëri lojë më të mirë, i mungoi goli dhe them shpyqyr që i mungoi, se donim ta fitonim në këtë trepikësh. Ishte filozofi e jona që të mbanim topin deri sa të gjenim hapësirat. Datëlindjen do ta bëj më shpesh, do e bëj një herë në tre muaj që kur të na duhet ndonjë trepikësh, ta marrim".

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Është edhe ai i mëngjesit.
3. Një piktor si Ligabue.
7. Një thirrje me emra
11. Në radhë të parë.
13. Era e kafesë.
16. Është nusja me vello.
17. Lear që këndon Tomorrow.
20. Një pjesë e nomenklaturës.
21. Gjysmë rebusi.
22. Ruhet nga polici.
23. Ai kapital është ekstrem.
25. Haan që qe trainer i yni.
26. Është operatori i TV.
28. Janë shakaxhinj.
29. Sateilit i Jupiterit.
31. Janë pallio ushtarake.
32. Cruise aktor.
34. Kryeqyteti i Libanit.
37. Fundi i një filmi.
38. Ka pasuri minerale.

**VERTIKAL**

1. Është tretës me zorrë.
2. Ishte muza e astronomisë.
4. Tre asa.
5. Inicialet e Reitman regjisor.
6. Janë tinguj.
8. Përfshijnë edhe karotat.
9. Është era pas Krishtit.
10. Simon i Duran Duran.
12. Malet me Akonkagua.
14. Një M në FMN.
15. Një vend si Katar.
18. Me të nxjerrin një metër.
19. Fundi i një fundi.
23. Lumë në SHBA.
24. Një pjesë e marrëzisë.
26. Është mistrec, qerrata.
27. Janë centralta si Chernobyl
28. Child i Byron.
30. Mbreti i eifëve.
31. Është bas me katër tela.
33. Gjashtëdhjetë në orë
35. Mbeten në fund.
36. Falen pa fe.
38. E dymbëdhjetë ajo e Shakespeare.
39. Argento aktore.
40. Opera e Verdit.
43. Gjysmë borxhi.
44. Ente Ndërtimi Greke.
47. Fillojnë dobët.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Një që pretendon të zgjidhet.
9. Bursa pa kufij.
12. Një tokë që fitohet
13. Janë shpendë që krakarisin.
14. Kalohet në gjumë.
15. Gjysmë ditari.
16. Gardner aktore.
17. Qëndrojnë mbi piedestal.
20. Të fundit në studim
22. Janë aftësitë me telepati
23. Kilmer aktor
25. Janë për plehra.
26. Ai ekzekutiv tani është bashki.
28. Kaluar në krye.
30. Janë pa shenjtorë në desktop.
31. Inicialet e Daudet.
33. Një Baba përrallor.

**VERTIKAL**


2. Fatal pa ekstreme.
3. Një peshë e pastër.
4. Pak dramatike.
5. Mbyllin një manastir.
6. Jepen me motivacion.
7. Kështu përfundon një uragan.
8. Përpilojnë akte juridike të tillë.
9. Është bekim... prifti.
10. Kompozoi në Bolero të famshme.
11. Një S në USA.
13. Është tregti me objekte të shenja.
14. Një që beson kollaj.
15. Janë kodra rëre.
17. Është mnetalprerëse si tornio.
18. I bëjnë tekanjozët.
19. Ndërmarrje Montimi Tiranë.
21. Janë njëvendëshe në Formula 1.
24. Një publik si bar.
27. Mund të jenë diesel të tilla.
28. Eahetë brinjë në skuadër.
29. Janë vegla.
32. U hahet të martuarve.
34. Fundi i njëen fatziu
35. Një teolog në xhami.
36. Ai i shtatë është kinemaja
38. Një pjesë njohurive.
40. Verifikuar pjesërisht.
43. Kufizojnë tatimet.
45. Fund janari.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

4		5	3	7		9	1	
9			1			2		
8	5							4
5		9		8				3
7			2		4			5
	4					7		
1		8	4		9			
	2			5			6	
						3		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	4	8	7	9	5	3	6	2
6	2	7	8	1	3	4	5	9
3	5	9	2	4	6	1	7	8
7	8	1	3	5	9	6	2	4
4	9	3	6	2	8	5	1	7
5	6	2	4	7	1	8	9	3
9	1	4	5	8	2	7	3	6
8	3	5	9	6	7	2	4	1
2	7	6	1	3	4	9	8	5

*Argëtim filozofik*

- Gabimi është i pranueshëm për ne sa kohë që jemi të rinj; por ai nuk duhet gërmuar në pleqëri.
- Çdo ditë ne duhet të dëgjojmë të paktën një këngë të vogël, të lexojmë në poezi të bukur, të shohim një pikturë të arrirë, dhe, nëse është e mundur, të flisim sa më pak fjalë.
- Të gjithë duan të jenë dikush; askush nuk do që të rritet.
- Vajzat dashurohen për ato që janë; djemtë për çfarë premtojnë të jenë.
- Shkoni në vendet e huaja dhe do të arrini të njihni gjërat e mira që i ke në atë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

12	16					1	12	9	2	16	12	12	M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K	
9	D	12	14		9		6	4	1	2	16	12	16	E	S	T	E	R	A		D	H	U	N	A	
2	E	15	12	16	2	16	2		4	5	2	8	4	I	T	E	A	T	E	R		M	I	N		
6	M	12	10	12	6	4	11	2						E	R	A		P	O	L	A	R		T	A	
			4	15	7	1	4	11	12	15	8	12		K	E	L		P	O	L	E	M	I	K	A	T
6	12	11	4	10	12	8	16	2	16			16	4	L		P	O	L	I	G	A	M	I			
16	5	12	5	2	6	4			16	16		4	1	E	T	A		P	I	K	A	T		R	E	L
1	2	8	2	16	2		4	17		9	11	16		K	O	M	O		D	E	N		T	O	K	E
		16	16		16	2	5	5	2	10	12			T	R	I		S	E		T	M		N	U	N
4	9	2		16		1	5	12	8	6	4	16		I	T		T	U	T	U		I	T	I	D	
11	2		6	7	5	12	4		6		4	2		K	A	D	E	T		K	O	S	H	L	E	
16		8	16	5	12	15	16	2	4	5	2			E	T	I	K		S	E	K	S	E	R	E	T

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**Argëtim filozofik**

**Chënie të mençura**



*Chënie të mençura*

- - Urrejta është aktive, zilia është pasive; por ka vetëm një hap midis zilisë dhe urrjetjes.
- - Është i vdekur në këtë botë ai që nuk beson në një botë tjetër.
- - Është më i lumturi, mbret apo bujk qoftë, ai që gjen paqe në shtëpinë e vet.
- - Unë mund të të them ty, mik i ndershëm, se kujt t'i besosh: besojti jetës; ajo të mëson më mirë se libri ose oratori.

